VENDIM
Nr.751, datë 7.11.2007

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SEKTORIALE TË PUNËSIMIT E TË FORMIMIT PROFESIONAL DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e strategjisë sektoriale të punësimit e të formimit profesional dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj, sipas teksteve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRATEGJIA SEKTORIALE E PUNËSIMIT
2007-2013

Tiranë, 2007

Hyrje

Nisur nga fakti se punësimi është një nga problemet shqetësuese imediate për Shqipërinë, merr në konsideratë faktin edhe pse rritja e PPB (GDP) ka qenë në nivele 6-8% në vitet e fundit, krijimi i vendeve të reja të punës në sektorin publik dhe privat ka qenë në nivele të ulëta, ashtu sikurse edhe në vendet e tjera të Europës Juglindore, Qeveria Shqiptare mbështetur në rekomandime të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare po harton Strategjinë Sektoriale të Punësimit me synim përmirësimin e indikatorëve të punësimit duke përpunuar politika më efikase.

Punësimi në përgjithësi është një sfidë komplekse dhe hapja e vendeve të reja të punës është një fenomen multisektorial, që përfshin politika makroekonomike, politika të favorshme për biznesin, politika arsimore, politika sociale etj., Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, e ndërgjegjshme për rolin që ajo duhet të luajë në fushën e politikave të punësimit do të punojë në bashkëpunim me partnerët dhe aktorët e tjerë për të koordinuar dhe arritur rezultate të prekshme për sfidën komplekse të punësimit. Për trajtimin sa më real dhe për t'i dhënë zgjidhje problemeve të punësimit, Strategjia ka marrë në konsideratë dhe i është referuar strategjive të tjera, si Strategjisë Kombëtare të Përfshirjes Sociale, Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Rajonal etj.

Strategjia Sektoriale e Punësimit ka për qëllim të vendosë bazat për përmirësimin e sistemit të shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional dhe zbatimit të programeve aktive dhe pasive të punësimit. Kjo strategji gjithashtu, del në mbështetje të programit të Qeverisë 2005–2009 në të cilin janë përcaktuar objektivat kryesorë për arritjen e punësimit të plotë dhe reduktimit të papunësisë. Këto objektiva janë:

- Krijimi i mundësive për punësim të çdo shqiptari. Papunësia, veçanërisht afatgjatë dhe e pashpresë, si urbane dhe rurale, veçanërisht në nivelet e larta të saj mes brezit të ri, përbën kërcënim serioz social dhe një barrierë për zhvillimin e vendit.
- Rritja e ritmeve të rritjes ekonomike njëkohësisht synon edhe që kjo rritje të krijojë vende të reja pune të mjaftueshme për të ulur papunësinë në nivelin e vendeve europiane, për të përballuar me mundësira punësimi shtesën demografike të popullsisë dhe për më tepër edhe për të filluar të ndikojë në kthimin e një pjese të emigrantëve.
- Përdorimi me efikasitet i programeve dhe instrumenteve të provuara si të suksesshme për të mundësuar axhustimet e defekteve të tregut të punës si p.sh. instrumentet e informacionit, të ndërmjetësimit, të trajnimeve profesionale, të incentivave fiskale etj.
- Programet e nxitjes së punësimit do të zbatohen në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat. Ato do t'u përshtaten realiteteve, nevojave dhe tendencave urbane, rurale e

rajonale.

- Vizioni i qeverisë për formimin bazohet në modelin e edukimit të vazhdueshëm duke filluar që në moshën parashkollore dhe që vazhdon gjithë jetën.

- Qeveria angazhohet për një reformë tërësore në formim të mbështetur nga burime të konsiderueshme publike, nga zgjerimi i mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë, si dhe përfshirja e sektorit privat në këtë fushë.

- Shpenzimet publike për edukimin dhe formimin, përfshirë atë universitar, të përbëjnë zërin e parë në Buxhetin e Shtetit duke arritur në një nivel prej 5% të PBB-së (në 2009).

Në strategji është përfshirë një vështrim i përgjithshëm i situatës së tregut të punës me të dhëna që kryesisht janë marrë nga INSTAT-i dhe nga studimi afatshkurtër i kryer nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit në vitin 2005.

Më konkretisht në strategji parashikohet përmirësimi i sistemit të shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional që synohet të realizohet nëpërmjet: i) krijimit të një sistemi modern dhe unik të shërbimeve të punësimit në të gjithë vendin; ii) ndërtimit dhe zhvillimit të marrëdhënieve të partneritetit me aktorë të tjerë në tregun e punës; iii) zhvillimit të teknologjisë së informacionit (IT) në shërbimet e punësimit si një faktor kyç për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve; iv) përmirësimit të kontakteve me ndërmarrjet: v) zhvillimit të burimeve njerëzore; vi) përmirësimit të bashkëpunimit me shërbimet private të punësimit; vii) krijimit të një sistemi unik dhe cilësor të AFP, i aftë për të kontribuar në zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive profesionale dhe qytetarisë aktive të të rinjve dhe të rriturve; viii) ofrimit të kualifikimeve profesionale në përputhje me kërkesat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit, në kuadrin e integrimit rajonal dhe europian.

Gjithashtu, në këtë strategji trajtohen dhe programe të cilat zbatohen nga zyrat e punësimit, si programi i nxitjes së punësimit, ai i pagesës së papunësisë, programet e reja në tregun e punës, programi i formimit profesional etj.

Në strategji është trajtuar dhe një pjesë në lidhje me krijimin e një klime pozitive për zhvillimin e biznesit dhe investimeve, rritjen e konkurrueshmërisë së SME-ve në tregun rajonal dhe atë global, nëpërmjet zhvillimit të teknologjisë dhe informacionit, reduktimit të barrierave administrative dhe krijimit të lehtësirave për biznesin.

Gjatë hartimit të kësaj strategjie janë mbajtur parasysh dhe janë marrë në konsideratë rekomandimet, vërejtjet dhe sugjerimet nga institucionet ndërkombëtare, si Banka Botërore, raporti i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për rishikimin e politikave të punësimit, si dhe janë mbajtur parasysh linjat udhëzuese të punësimit të shteteve anëtare të Bashkimit Europian.

KAPITULLI I
KUSHTET AKTUALE

Reformat makroekonomike dhe ristrukturimi i fillimit të viteve 90 pakësoi kërkesën për punë në Shqipëri, ashtu, si dhe në vendet e tjera në tranzicion ekonomik, vendi pësoi një rënie të normës së pjesëmarrjes në forcat e punës. Privatizimi në masë i ndërmarrjeve shtetërore të mbyllura, gjithashtu dhe rritja e konkurrencës për një numër të reduktuar vendesh pune, detyroi shumë njerëz të tërhiqeshin nga forcat e punës.

Rënia e ndjeshme në nivelin e pjesëmarrjes në punë të forcave të punës mund të ketë shkaqe të ndryshme, si për shembull një numër i konsiderueshëm personash punojnë në sektorin informal, të tjerët mund të jenë dekurajuar nga situata e tregut të punës dhe janë larguar nga fuqia punëtore[1].

Këta tregues lidhen gjithashtu me situatën e sotme të tregut të punës ku punësimi i femrave bie për shkaqe, si: i) mbyllja e mjaft aktiviteteve të mëparshme industriale të zhvilluara para viteve 90-të, me numër të lartë të femrave të punësuara në to; ii) zhvillimi i aktiviteteve ekonomike të orientuara më shumë nga punësimi i meshkujve, si tregtia apo ndërtimi; iii) lëvizja rurale-urbane, e cila nuk u jep shumë mundësi femrave të ardhura nga zonat rurale të hyjnë në tregun urban të punës, kjo për shkak të nivelit të ulët të arsimimit, nivelit aktual të teknologjive etj.

Shkalla e pjesëmarrjes së meshkujve në forcat e punës ka qenë historikisht më e lartë sesa shkalla e pjesëmarrjes së femrave dhe vitet e tranzicionit ndikuan në të punësuarit femra më shumë se në meshkujt. Në vitin 1998 për shembull, si pasojë e krizave të skemave piramidale shkalla e pjesëmarrjes së meshkujve

[1] Hobdari, B: "Tregu i punës dhe pabarazitë rajonale të papunësisë në Shqipëri". Seri të Europës Lindore nr.53. Instituti për Studime të Avancuara, Vjenë, 1998.

në forcat e punës ishte 89.5 për qind kundrejt vetëm 59.8 për qind të femrave në moshë pune pjesëmarrëse në forcat e punës.

Bilanci i forcave të punës 1994-2006

Në mijë

VITET	**1994**	**1995**	**1996**	**1997**	**1998**	**1999**	**2000**	**2001**	**2002**	**2003**	**2004**	**2005**	**2006**
Popullsia gjithsej	**3202**	**3075**	**3075**	**3075**	**3055**	**3054**	**3061**	**3074**	**3093**	**3111**	**3127**	**3142**	**3142**
- Meshkuj	1586	1570	1577	1566	1543	1533	1530	1533	1542	1551	1558	1577	1577
- Femra	1616	1480	1498	1509	1512	1521	1531	1541	1551	1560	1569	1565	1565
Popullsia në moshë pune-	**1786**	**1759**	**1774**	**1773**	**1762**	**1761**	**1765**	**1773**	**1800**	**1826**	**1850**	**1877**	**1877**
-Meshkuj	900	897	905	904	898	898	900	906	919	931	944	959	959
- Femra	886	862	869	869	864	863	865	867	881	895	906	918	918
Forcat e punës gjithsej	**1423**	**1309**	**1274**	**1301**	**1320**	**1305**	**1283**	**1101**	**1092**	**1089**	**1088**	**1085**	**1083**
-Meshkuj	814	775	764	794	803	791	754	674	668	665	660	655	653
-Femra	609	534	510	507	517	514	529	427	424	424	428	430	430
Përqindja e pjesëmarrjes në punë të forcave të punës	**79.6**	**74.4**	**71.8**	**73.4**	**74.9**	**74.1**	**72.7**	**62.0**	**60.6**	**59.6**	**58.8**	**57.8**	**57.8**
-Meshkuj	90.0	86.3	84.4	87.8	89.4	88.0	83.7	74.4	72.7	71.4	69.9	68.3	68.3
-Femra	68.7	61.9	58.7	58.3	59.8	59.5	61.1	49.2	48.1	47.3	47.2	46.8	46.8
Niveli i punësimit	**65.0**	**64.7**	**63.0**	**62.4**	**61.6**	**60.4**	**60.5**	**52.0**	**51.1**	**50.7**	**50.3**	**49.7**	**49.6**
-Meshkuj	74.8	76.2	74.7	75.6	75.3	73.6	71.2	63.8	62.8	62.2	61.2	60.0	60.0
-Femra	55.0	52.6	50.6	48.7	47.3	46.8	49.3	39.6	39.0	38.8	38.9	38.8	38.8
Papunësia e rregjistruar në %	**18**	**13%**	**12**	**15**	**18**	**18**	**17**	**16**	**15**	**15**	**14.4**	**14.1**	**13.8**
- Meshkuj	17	12	12	14	16	16	15	14	14	13	12	12.1	12
- Femra	20	15	14	17	21	21	19	20	19	18	18	17.2	17.1

Burimi : INSTAT

Punësimi

Tregu shqiptar i punës mbas viteve 90-të është shoqëruar nga nivele të ulëta të punësimit karakteristike e vendeve në tranzicion. Reduktimi i nivelit të punësimit të viteve 90 vjen edhe si rezultat i rënies së punësimit në sektorin shtetëror. Numri i të punësuarve në sektorin shtetëror u ul nga 850 000 në vitin 1991 në 189 000 në vitin 2001, dhe në 176 000 në vitin 2004. Kjo rënie e punësimit në këtë sektor erdhi si pasojë e privatizimit në masë të ndërmarrjeve shtetërore. Liberalizimi i çmimeve, fundi i shtetit socialist, mungesa e kapitalit dhe konkurrenca e huaj – masa të ndërmarra për të bërë ekonominë kombëtare konkurruese afatgjatë-dobësuan ndjeshëm ndërmarrjet e reja të privatizuara dhe i çuan ato në falimentim. Sektori industrial - nxjerrja e mineraleve, metalurgjia, fabrikimi i pajisjeve dhe pjesëve të ndërrimit, industria kimike dhe ajo e letrës dhe e tekstileve - ishin më të goditurat. Pakësimi i të ardhurave vjetore çoi në uljen e numrit të vendeve të punës në strukturat shtetërore.

Niveli i punësimit 1994 – 2006



Burimi : INSTAT

Dhe brenda strukturës së punësimit sipas sektorëve vihen re ndryshime të rëndësishme, ndërsa në vitin 1995 punësimi në sektorin shtetëror zinte 33 për qind, në vitin 2006 ky sektor përbën rreth 18 për qind të numrit gjithsej të të punësuarve, kjo si pasojë e reformave të privatizimit të zhvilluara në këtë sektor. Ndërsa punësimi në sektorin privat jobujqësor ka tendenca në rritje, nga rreth 10 për qind që zinte ky sektor në vitin 1995, arrin në 24 për qind të të punësuarve gjithsej për vitin 2006.

Femrat e punësuara zënë 37 për qind të totalit të punësimeve. Analiza e nivelit të punësimeve në vite, tregon se gjatë gjithë periudhës 1993–2006 niveli i punësimit të femrave vazhdon të jetë dukshëm më i ulët se ai i meshkujve.

Brenda strukturës së punësimit sipas sektorëve vihen re ndryshime të rëndësishme, ndërsa në vitin 1995 punësimi në sektorin shtetëror zinte 33 për qind, në vitin 2006 ky sektor përbën 16 për qind të numrit gjithsej të të punësuarve, kjo si pasojë e reformave të privatizimit të zhvilluara në këtë sektor. Ndërsa punësimi në sektorin privat jobujqësor ka tendenca në rritje, nga rreth 10 për qind që zinte ky sektor në vitin 1995, arrin në 33 për qind të të punësuarve gjithsej për vitin 2006.

Të punësuar sipas sektorëve



Burimi : INSTAT

Aktualisht numri i të punësuarve është rreth 932 mijë persona. Pjesa më e madhe e të punësuarve punon në bujqësi me 51%. Një pjesë e të punësuarve punon në ndërtim dhe transport me 12.7% në tregti 11.6%, e ndjekur më pas nga industria me 7.1%. Përqindja e lartë e punësimit në bujqësi tregon se shoqëria shqiptare mbetet ende me një popullsi rurale me gjithë lëvizjet e mëdha drejt zonave urbane.

Të punësuarit sipas aktiviteteve ekonomike viti 2005



Burimi : INSTAT

Femrat e punësuara zënë 37% të totalit të punësimeve. Analiza e nivelit të punësimeve në vite, tregon se gjatë gjithë periudhës 1993–2006 niveli i punësimit të femrave ka qenë dukshëm më i ulët se ai i meshkujve. Kjo diferencë vazhdon të ruhet dhe mbetet në të njëjtat nivele. Diferencat midis nivelit të punësimit femra meshkuj janë më të theksuara në sektorin privat jo bujqësor, ku numri i femrave të punësuara zë vetëm 25 %.

1.2 Sektori informal

Sektori informal në Shqipëri është analizuar duke përdorur të dhëna për punësimin individual dhe të dhëna mbi sipërmarrjet familjare jofermere. Të dhënat mbi punësimin tregojnë se rreth 10% e të punësuarve në Shqipëri punojnë si sipërmarrje familjare jofermere ose si punëtorë që punojnë për llogari të tyre. Masa e sektorit informal në Shqipëri është më e madhe në zonat urbane (24%) se në zonat rurale (5%). Rreth 15 % e të punësuarve në Tiranë janë punëtorë që punojnë për llogari të tyre ose punëtorë të sipërmarrjeve familjare jofermere.

Pothuajse tre të katërtat e individëve në sektorin informal janë të punësuar për të paktën tre vjet dhe rreth 10% e tyre janë të përfshirë në sektorin informal për më shumë se 10 vjet. Më shumë se 90% e personave në sektorin informal kanë filluar biznesin e tyre si një mënyrë për të kërkuar punë.

1. 3 Vetëpunësimet

Koncepti i vetëpunësimit hyri për herë të parë mbas vitit 1992 me mbylljen e ndërmarrjeve industriale dhe ristrukturimin e ekonomisë së vendit. Vetëpunësimet kanë pësuar një tendencë rritjeje nga viti në vit. Në shkallë vendi rreth 66 për qind e atyre që konsiderohen në punë janë të vetëpunësuar dhe vetëm 34 për qind janë të punësuar me pagesë. Vetëpunësimet në Shqipëri kanë karakter të biznesit familjar kryesisht në tregti e artizanat trashëgues të familjes. 62% për qind e të punësuarve janë me kohë të plotë dhe 39 për qind kanë punë me kohë të pjesshme, ndërkohë që të punësuar me kohë të plotë më shumë janë meshkuj (70 për qind) sesa femra 51 për qind. Janë shumë individë me arsim të lartë të cilët punojnë me kohë të plotë (75 për qind), krahasuar me të punësuarit me arsim të mesëm (73 për qind), dhe me ata me arsim të ulët (55 për qind). Niveli i punësimit në Tiranë ishte vetëm 39 % dhe ishte më e ulëta në të gjithë rajonet e Shqipërisë.

1.4 Papunësia

Në fund të muajit dhjetor 2006 numëroheshin rreth 150 mijë të papunë të regjistruar ose 13.8%, nga të cilët 10 mijë përfitojnë trajtim me pagesë papunësie, kur në fund të vitit 2005 numëroheshin rreth 153 mijë të papunë të regjistruar. Shkalla e papunësisë në nivel vendi në muajin dhjetor 2006 është 0.3 % më e ulët se në fund të vitit 2005.

Papunësia 1991 –2006



Burimi: MPÇSSHB

Shkalla e papunësisë në nivel vendi në fund të vitit 2006 ishte 13.8%. Kjo shifër ka një rënie me 0.3% në krahasim me fundin e vitit 2005 ku niveli i papunësisë ka qenë 14.1%. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e uljes së numrit të përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike, nga rritja e numrit të ndërmjetësimeve.

Forcat aktive dhe papunësia vitet 2000–2006



Burimi: MPÇSSHB

Niveli i papunësisë ka qenë më i lartë te femrat gjatë gjithë periudhës së tranzicionit. Mbyllja e shumë ndërmarrjeve industriale të specializuara në punësimin e fuqisë punëtore femra, solli papunësi të lartë në këtë kategori. Nga ana tjetër kjo kategori e fuqisë punëtore, ndryshe nga meshkujt, provoi se e kishte shumë të vështirë përshtatjen me situatën e re të tregut të punës.

Papunësia në meshkuj dhe femra 1996–2006



Burim: MPÇSSHB

Diferenca në shkallën e papunësisë ndërmjet femrave dhe meshkujve është më e theksuar në zonën urbane sesa në atë rurale.

Analiza e të papunëve të regjistruar sipas grupmoshave dëshmon se gjatë gjithë periudhës së tranzicionit mesatarisht 60% të punëkërkuesve të regjistruar janë nën moshën 34 vjeç. Të rinjtë e grupmoshës 15-25 vjeç përbëjnë 25% të totalit të punëkërkuesve të papunë. Në fund të vitit 2004, grupmoshat deri në 34 vjeç dhe ato mbi 35 vjeç janë të ndarë në mënyrë të barabartë dhe në vitin 2005 numri i punëkërkuesve të papunë mbi moshën 35 vjeç përbëjnë 51% e numrit total të punëkërkuesve.

Papunësia sipas grupmoshave 1993–2006



Burimi: MPÇSSHB

Niveli i papunësisë është më i lartë në zonën verilindore të vendit. Kjo është e lidhur kryesisht me faktin se kjo zonë nuk ka qenë e aftë të rikuperojë aktivitetet ekonomike të humbura pas viteve ’90, sepse kjo është një zonë malore dhe me infrastrukturë të varfër, si dhe ka pasur mungesë së mundësive të lëvizjes në vendet fqinje. Gjithashtu, vërehet një prirje e biznesmenëve për ta kaluar aktivitetin në qytetet e zhvilluara. Hapja e rrugës Durrës–Morinë dhe rritja e investimeve të Buxhetit të Shtetit në zonën verilindore janë elemente, të cilat do të ulin nivelin e lartë të papunësisë në zonën verilindore.

Papunësia sipas ndarjes demografike për vitin 2006



Burimi: MPÇSSHB

Në strukturën e të papunëve sipas nivelit arsimor vendin kryesor me rreth 54.6% e zënë punëkërkuesit e papunë me arsim fillor e tetëvjeçar. Ky grup është dhe kontingjenti më pak i kualifikuar. Punëkërkuesit me arsim të mesëm profesional përbjënë 43.6%, ndërsa punëkërkuesit me arsim të lartë zënë një përqindje të papërfillshme vetëm 1.8% të punëkërkuesve.

Papunesia sipas nivelit arsimor 2006



Burimi: MPÇSSHB

Struktura e punëkërkuesve të papunë sipas kohës që qëndrojnë të regjistruar pranë zyrave të punësimit, dëshmon për mbizotërimin absolut të të papunëve afatgjatë dhe të tillë konsiderohen ata që figurojnë të regjistruar pranë zyrës së punësimit prej më shumë se një vit. Kjo kategori e të papunëve përbën një problem të madh për vendin, pasi natyra e ristrukturimit të ekonomisë dhe thithja e kësaj kategorie nga tregu i punës është shumë i vështirë. Të papunët afatgjatë gjatë periudhës 1993–2006 përbëjnë mesatarisht 66% të të papunëve në total. Struktura e papunësisë afatgjatë është:

66% e të papunëve;
46% femra;
56 % me arsim tetëvjeçar;
54% mbi 35 vjeç.

Të dhënat e LSMS tregojnë se shumica e të papunëve nuk i drejtohen zyrave të punësimit në përpjekjet e tyre për të gjetur një punë të përshtatshme sidomos punëkërkuesit e kualifikuar. Grafiku më poshtë tregon se rreth një e pesta e të papunëve gjatë viteve 2002–2004 kanë kërkuar punë nëpërmjet shërbimeve të zyrave të punësimit. Mbi 60% e këtyre individëve përdorin mjete të tjera si nëpërmjet miqve apo të afërmve për të gjetur punë. Këtu vlen të theksohet fakti se shërbimet e punësimit mbulojnë vetëm

zonën urbane të vendit. Për rritjen e punësimit sidomos të nxënësve që përfundojnë shkollat e mesme profesionale duhet të rritet bashkëpunimi ndërmjet zyrave rajonale dhe vendore të punësimit me drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore dhe shkollat profesionale dhe të shikohet mundësia e përfshirjes në programin e praktikave profesionale edhe të nxënësve që përfundojnë shkollat e mesme profesionale.

Metodat e përdorura nga të papunët për kërkimin e një pune të parë LSMS periudha 2002–2004



Të dhënat statistikore në lidhje me shkallën e papunësisë shprehen me numrin e të papunëve të regjistruar, sepse në Shqipëri deri më sot nuk bëhen studime në lidhje me fuqinë punëtore (INSTAT ka planifikuar kryerjen e një studimi të tillë në vitin 2007). Siç është thënë tashmë kjo është një mangësi e madhe për statistikat e Shqipërisë. Shpesh argumentohet se regjistrimi i numrit të papunëve në Shqipëri nuk është një matës i përshtatshëm për nivelin real të papunësisë dhe nuk pasqyron presionin-tensionin real të tregut të punës. Disa nga këto arsye lidhen me nivelin e lartë të informalitetit, të emigracionit, të papunësisë së fshehur në bujqësi dhe numrin e madh të të papunëve që nuk janë të regjistruar.

1.5 Pagat

Para viteve 90-të, niveli i pagave në Shqipëri ishte më e ulti në Europë. Kriza ekonomike në fillimet e viteve 90-të e përkeqësoi më tej këtë situatë. U zbatuan reforma të tregut me synim që të stimulohej rritja e ekonomisë. Politika kufizuese mbi të ardhurat ishte pjesë e rëndësishme e këtij programi që synonte të kufizonte inflacionin. Pagat reale ranë pothuajse 50% gjatë viteve 1991-1993. Në 1994 dhe 1995 paga reale u rrit në shkallë vjetore 25 për qind. Kriza e skemave piramidale dhe inflacioni i lartë i vitit 1997 megjithatë, i zbehu këto arritje dhe paga reale ra në 17 për qind.

Kriza e vitit 1997 kontribuoi, gjithashtu në kufizimin e rritjes së pagave, por nuk ishte arsyeja e vetme. Ndërmarrjet më fitimprurëse u ndaluan të paguanin rroga të larta nëpërmjet kontrollit të rreptë të pagave[2].

Stabilizimi makroekonomik i paskrizës, shkalla njëshifrore e inflacionit në vitet e fundit, lejoi pagën reale të fitojë rritje përsëri. Dhe që nga viti 1998 ajo është rritur me 10 për qind çdo vit.

[2] Raporti ILO –KE Rishikimi i Politikave të Punësimit.

Rritja reale e pagës në sektorin shtetëror 1994-2004



Ndërmjet viteve 1997-2004, transporti dhe komunikacioni kanë pasur rritjen më të lartë nominale të pagës midis degëve të industrisë. Gjatë viteve 1999-2001 paga mesatare mujore në transport dhe komunikacion ka qenë më e larta. Rritja e pagave në sektorin e shërbimeve ka qenë në vend të dytë, më i larti sipas degëve.

Sipas studimeve të kryera nga INSTAT (Anketa e matjes së nivelit të jetesës 2002, 2003, 2004) meshkujt kanë paga më të larta se femrat në të gjithë sektorët, por kjo lidhet me pagën e vendit të punës ku në vende pune me paga më të larta vendosen këta të fundit. Diferenca në pagën mesatare ndërmjet meshkujve dhe femrave është pothuajse e papërfillshme në sektorin shtetëror.



Burimi: INSTAT

1.6 Arsimi dhe formimi profesional

Transformimet, që sollën lindjen e ekonomisë së tregut, kanë shtruar para shoqërisë nevojën për nivele të reja kualifikimi në drejtim të teknologjive e shërbimeve të reja.

Orientimi nga tregu i punës, si dhe nga praktika, së bashku me kërkesën për fleksibilitet, janë tani pika të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të AFP, për t'i dhënë atij një fytyrë të re dhe për të edukuar dhe pajisur brezat e rinj me kualifikimet dhe shkathtësitë e shprehitë (skills) e nevojshme, që kërkohen sot nga tregu i punës.

Sistemi aktual i arsimit dhe formimit profesional (AFP) në Shqipëri është i dobët, si nga pikëpamja sasiore, ashtu dhe nga cilësia. Në përgjithësi, ka mungesë të infrastrukturës së përshtatshme, financim të pamjaftueshëm, nivel të ulët të burimeve njerëzore, kurrikula relativisht të vjetëruara që nuk përputhen me nevojat e tregut dhe metodë menaxhimi të tejkaluar.

Aktualisht në shkallë vendi funksionojnë 40 shkolla të arsimit teknik e profesional, të shpërndara në 22 rrethe. Nga këto, në zonat rurale funksionojnë 3 shkolla profesionale, me drejtim kryesor bujqësi-agrobiznes.

Përsa i përket formimit profesional (FP), operon nëpërmjet 9 qendrave publike të formimit profesional në qytetet më të mëdha të vendit, si Vlorë, Shkodër, Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Tepelenë dhe Fier, si dhe 120 subjekte private të licencuara, nga të cilat 24 janë QJF, me një shtrirje në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Në qendrat e formimit profesional organizohen kurse afatshkurtra (nga 6-7 javë deri në 4 muaj në qendrat publike, dhe 1 javë deri në 2 vjet në qendrat private). Nga të dhënat e vitit 2006, 72% e kualifikimeve u realizuan në kompjuter dhe gjuhë të huaja dhe pjesa tjetër në rreth 17 profesione të mirëfillta. Vetëm në qendrat publike janë regjistruar 7574 kursantë, nga të cilët 7004 vetë janë të certifikuar. Rreth 57.93% e pjesëmarrësve janë femra. Kurset e formimit profesional në qendrat publike frekuentohen më shumë nga personat deri në moshën 24 vjeç (62.87%) dhe 56.17% e tyre kanë mbaruar arsimin e mesëm dhe profesional. Rreth 41.42% e pjesëmarrësve janë të papunë, nga të cilët 17.89% e tyre janë të regjistruar si të papunë (kjo shifër varion sipas llojit të kurseve dhe sipas rretheve).

Megjithatë, si arsimi profesional, ashtu dhe formimi profesional vazhdojnë të kenë një nivel të ulët nga pikëpamja cilësore dhe në to angazhohen një përqindje mjaft e ulët e nxënësve, të rinjve apo të rriturve. Edhe sektori privat i AFP është ende i dobët dhe karakterizohet nga tipare të ngjashme me atë publik.

Problemet që po përjeton sistemi i AFP bëjnë të domosdoshëm intensifikimin e reformës në këtë sektor. Qëllimi final është harmonizimi i politikave të AFP ndërmjet tyre, si dhe me politikat e fushave të tjera, të interesuara për zhvillimin e burimeve njerëzore, ekonomike, sociale, të tregut të punës etj. Kjo kërkon përdorim sa më racional të burimeve financiare e njerëzore, gjithmonë duke pasur parasysh realitetin dhe kushtet e vendit tonë.

Integrimi europian parashtron kërkesa të tilla, që e bëjnë të domosdoshëm përfshirjen e AFP-së në rrjedhën e zhvillimeve bashkëkohore, në harmoni me ato çka po ndodhin në rajon dhe Bashkimin Europian. Ndikimet e proceseve të Bolonjës, Lisbonës dhe Kopenhagës tashmë janë të pranishme dhe në Shqipëri dhe po ushtrojnë një "presion" pozitiv në nivelet politike për të kaluar nga "riparimet e pjesshme sipas nevojave të çastit" drejt "zgjidhjeve të plota e afatgjata" në kontekstin e integrimit rajonal dhe europian.

Kështu, politika e reformimit të AFP-së në Shqipëri, përveç trajtimit të çështjeve tradicionale, si kurrikulat, trajnimi i mësuesve/instruktorëve, pajisja e shkollave/qendrave, tashmë ka filluar të orientohet gjithnjë e më tepër drejt një "reforme sistemike" duke përfshirë çështje të tilla, si Kuadri Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale (KKKP), zhvillimi institucional, akreditimi, certifikimi, analiza e tregut, analiza e nevojave, standardet, partneriteti social etj.

1.7 Probleme të identifikuara në tregun e punës dhe masat që po ndërmerren

Tregu shqiptar i punës karakterizohet nga disa probleme për të cilat qeveria po merr masa të cilat duhet të ndikojnë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e situatës së këtij tregu që do të sjellë si pasojë rritjen e nivelit të punësimit. Ndër to mund të përmendim:

- Përmirësimi i klimës së biznesit në kuadrin e reduktimit të taksave sidomos për biznesin e vogël, si dhe ulja e masës së kontributeve për sigurime shoqërore e shëndetësore (kostos së punës).

- Hapja e vendeve të reja të punës në sektorin privat jobujqësor me më shumë produktivitet dhe me pagë më të lartë përbën një element të rëndësishëm për uljen e varfërisë dhe përmirësimin e standardit të jetës. Hapja e vendeve të reja punës është një sfidë në një kohë kur oferta e krahut të punës do të rritet me shpejtësi për shkak të rritjes demografike dhe modernizimit që do ta çojnë aktivitetin ekonomik në aktivitete që kërkojnë më pak krahë pune jashtë sektorit të bujqësisë.

- Tregu shqiptar i punës vuan akoma një nivel të lartë të tregut informal. Për më tepër ka pak lëvizshmëri ndërmjet sektorit informal dhe atij formal. Sigurimi i stimujve më të favorshme për formalizmin e vendeve të punës, kontraktimi më fleksibël do të ndihmonte në mënyrë të veçantë të punësuarit më vulnerabël. Hartimi i planit të aksionit i miratuar nga Qeveria me përfshirjen e shumë aktorëve në tregun e punës është një hap drejt zbatimit të politikës qeveritare për përmirësimin e situatës së tregut të punës.

- Personat me nivel arsimor të ulët ndeshen me probleme të konsiderueshme në tregun e punës. Ka një përqendrim të personave me arsim minimal apo pa arsim në sektorin informal. Niveli i arsimimit është i lidhur ngushtë dhe me nivelin e të ardhurave. Zgjerimi i aksesit për arsimin dhe formim profesional është shumë i rëndësishëm. Në të ardhmen, me urbanizimin e ekonomisë dhe largimin e saj nga sektori bujqësor, zhvillimi i kapitalit njerëzor do të marrë një rëndësi akoma më të madhe.

- Megjithëse migracioni është konsideruar si një burim mjaft i mirë të ardhurash për familjet

shqiptare dhe instrument i dobishëm në menaxhimin e riskut ai nxit fenomenin e qarkullimit të trurit. Qarkullimi i trurit ofron përfitime potenciale për të ardhmen, sepse emigrantët kanë përfituar formim profesional dhe përvojë në vendet e emigrimit. Shumë pozitive në drejtim të nxitjes së emigrantëve që kthehen dhe duan të hapin biznese të reja në Shqipëri është nisma e re e qeverisë për përjashtimin nga taksat për një kohëzgjatje të caktuar për këto biznese.

- Gratë vazhdojnë të kenë nivele të ulëta punësimi dhe nivele të larta papunësie. Pagat për gratë janë 35% më të ulëta sesa ato për meshkuj, duke pasur parasysh këtu moshën, arsimimin dhe karakteristika të tjera personale. Ndërsa niveli i papunësisë në komunitetet e romëve është rreth 70% dhe pjesa e atyre që janë të punësuar përgjithësisht marrin paga shumë të ulëta dhe shpesh janë të punësuar në punë me rreziqe në sektorin informal kjo ka pasoja negative në përgjithësi dhe ndikon në mirëqenien sociale të këtyre grupeve.

- Mungon studimi i forcave të punës (labour force survey), i cili do të kryhet nga INSTAT, studim i cili parashikohet të fillojë të aplikohet në vitin 2007. Me anë të këtij studimi INSTAT do të jetë i aftë të furnizojë me të dhëna zyrtare në lidhje me nivelin e papunësisë, punësimin, kualifikimin profesional të fuqisë punëtore, karakteristikat e papunësisë etj. Indikatorët e marrë nga ky studim duhet të jenë të tillë që të monitorohen nga Komisioni Europian dhe nga vendet anëtare. Të dhëna të tilla do të sillnin hartimin e politikave të duhura dhe rritjen e efikasitetit të këtyre politikave.

Në kuadrin e programit të qeverisë synohet krijimi i mundësive për punësim të çdo shqiptari. Rritja e ritmeve të rritjes ekonomike njëkohësisht synon edhe që kjo rritje të krijojë vende të reja pune të mjaftueshme për të ulur papunësinë në nivelin e vendeve europiane, për të përballuar me mundësira punësimi shtesën demografike të popullsisë dhe për më tepër edhe për të filluar të ndikojë në kthimin e një pjese të emigrantëve. Përdorimi me efikasitet i programeve dhe instrumenteve të provuara si të suksesshme për të mundësuar axhustimet e defekteve të tregut të punës, si p.sh. instrumentet e informacionit, të ndërmjetësimit, të trajnimeve profesionale, të incentivave fiskale etj.

KAPITULLI II
VIZIONI, PRIORITETET DHE QËLLIMI STRATEGJIK

Strategjia sektoriale e punësimit ka për qëllim të hedhë bazat kryesore strategjike për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zhvillimin e sistemit të shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional. Baza e kësaj do të jetë përmirësimi i cilësisë së shërbimeve ndaj klientëve punëkërkues dhe atyre punëdhënës nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të punësimit, zbatimit sa më efikas të programeve aktive dhe pasive.

Qëllimi kryesor është ulja e nivelit të papunësisë në nivelin e papunësisë të vendeve të BE-së gradualisht deri në vitin 2013. Në bazë të strategjisë europiane të punësimit do të synohet që nëpërmjet zbatimit të politikave të punësimit synohet punësimi i plotë, përmirësimi i cilësisë dhe produktivitetit në punë dhe forcimi i kohezionit social.

Për arritjen e objektivave të mësipërm prioritetet kryesore që do të ndërmerren në kuadrin e kësaj strategjie janë:

- ulja e nivelit të papunësisë me 0.3% - 04% çdo vit;
- rritja e të punësuarve me 1.9% - 2.2% në vit;
- 20% e të papunëve të regjistruar të marrin pjesë brenda vitit 2013 në një program aktiv në formën e trajnimit, ritrajnimit, praktikave në vendin e punës ose masave të tjera që gjenerojnë punësim;
- programe për hapjen e vendeve të reja të punës dhe mbajtjen e atyre ekzistuese;
- nxitja e formimit profesional gjatë gjithë jetës;
- rritjen e investimeve në kapitalin njerëzor;
- sigurimin e të gjithë mbështetjes shtetërore për të papunë dhe grupet në nevojë;
- përmirësimin e performancës së rrjetit të shërbimeve të punësimit brenda kapaciteteve ekzistuese;
- krijimi i një klime pozitive për zhvillimin e biznesit dhe investimeve, rritja e konkurrueshmërisë së SME-ve në tregun rajonal dhe atë global, nëpërmjet zhvillimit të teknologjisë dhe informacionit, reduktimit të barrierave administrative dhe krijimit të lehtësirave për biznesin;
- ngushtimi gradual i peshës së sektorit informal.

KAPITULLI III
POLITIKAT

3. Evidentimi i prioriteteve kryesore për politikën e punësimit dhe formimit profesional

3. 1 Politikat aktive të tregut të punës

Politikat aktive të punësimit në Shqipëri për herë të parë u prezantuan në vitin 1995 në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit" duke krijuar bazat e para të një pakete programesh, si: i) ndërmjetësimi për punë dhe profesion; ii) këshillimi për punë dhe profesion; iii) formimi profesional; iv) programet e nxitjes së punësimit etj.

Objektivi kryesor i politikave të punësimit është mbështetja e punëkërkuesve në gjetjen e një pune të përshtatshme. Politikat e punësimit janë një mjet i rëndësishëm për përmirësimin e situatës së tregut të punës, por gjithsesi kanë akoma një impakt të kufizuar në uljen e nivelit të papunësisë. Kjo vjen si rezultat i disa faktorëve në tregun e punës që janë të lidhur me faktin se politikat e tregut të punës janë të kushtueshme dhe kërkojnë më shumë njerëz për t'i zbatuar ato.

3.2 Kuadri ligjor

Ligji bazë në fushën e punësimit është ligji nr.7995, datë 20.9.2005 "Për nxitjen e punësimit". Ky ligj mbështet si zbatimin e programeve për zhvillimin e punësimit, ashtu edhe ngritjen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe Fondit Kombëtar të Punësimit.

Ndryshimet e fundit të ligjit të miratuara në muajin korrik 2006 kanë përmirësuar disa çështje në lidhje me: i) përmirësimin e përkufizimeve të tij dhe përfshirjen e përkufizimeve të reja të cilat kanë të bëjnë me programe dhe kategori të ndryshme personash që përfitojnë nga ky ligj; ii) futjen e konceptit të këshillimit dhe orientimit për profesion dhe punësim si pjese e shërbimeve të punësimit; iii) hartimin e programeve të reja si p.sh. ai i praktikave profesionale për të rinjtë; iv) ndryshimin e procedurave të menaxhimit të fondeve të formimit profesional, ndryshim ky që vjen si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit nr.8872, datë 19.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" dhe miratimin e statutit tip të qendrave publike të formimit profesional.

3.3 Programet aktive në tregun e punës

3.3.1 Shërbimet e punësimit

Shërbimi publik i punësimit në tregun e punës zbatohet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Shërbimi Kombëtar i Punësimit është një shërbim publik autonom, me statusin e një administrate shtetërore, qendrore, që përgjigjet para Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Organi më i lartë vendimmarrës i Shërbimit Kombëtar të Punësimit është Këshilli Administrativ Trepalësh me pjesëmarrjen e 3 përfaqësuesve të punëdhënësve, 3 të punëmarrësve dhe 7 të shtetit.

Shërbimet e ofruara nga SHKP përfshijnë aktivitetet, si: i) regjistrimin e punëkërkuesve; ii) ndërmjetësim për punë (përputhjen e kërkesës me ofertën për punë); iii) orientim dhe këshillim për punëkërkuesit; iv) përgatitjen e dokumentacionit të përfitimeve të papunësisë; v) orientim dhe vendosje në kurset e formimit profesional; vi) mbledhjen e informacionit mbi tregun e punës; vii) zbatimin e programeve për nxitjen e punësimit.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit si institucion që ofron shërbime dhe zbaton politikat e punësimit në tregun e punës e realizon këtë mision me anë të një rrjeti prej 36 zyrash punësimi me një staf total prej 372 punonjësish (përfshi këtu stafin drejtues, stafin që ofron drejtpërdrejt shërbime ndaj klientëve dhe stafin mbështetës). Rrjeti i zyrave të punësimit paraqitet, si më poshtë: 12 zyra rajonale me një staf prej 190 personash dhe 24 zyra lokale me një staf prej 136 personash.

Me gjithë përparimet në drejtim të kalimit nga politikat pasive në ato aktive, është evident fakti që shërbimet e punësimit duhet të orientohen drejt zotërimit dhe përmirësimit të situatës së tregut të punës. Aktualisht rreth 47% e numrit të përgjithshëm të punonjësve të zyrave të punësimit punojnë dhe ofrojnë shërbime për 149 000 punëkërkues të papunë të regjistruar në zyrat e punësimit ndërkohë që në vendet e BE kjo përqindje është në masën 62-65%.

Në këtë kuadër objektivi i SHKP për vitin 2007-2013 brenda stafit ekzistues është të përmirësojë raportin e punonjësve të shërbimeve nga 47 % ne 55 %, në raport me punonjësit mbështetës.

Për zbatimin e rekomandimeve të raportit CREP zhvilluar nga ILO dhe Këshilli i Europës në vitin 2004 në kuadër të kësaj strategjie, rezultat i pritshëm është realizimi çdo vit i një takimi vjetor në nivel rajonal me pjesëmarrjen e zyrës së punësimit, përfaqësuesve të biznesit, dhomës së tregtisë, autoriteteve lokale për të prezantuar situatën e tregut të punës dhe formimit profesional në nivel rajonal.

Rezultat tjetër i pritshëm është organizmi i panaireve të punësimit në 6 rajone pilote gjatë vitit 2007 (Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Korçë dhe Shkodër). Shtrirjen e kësaj eksperience në 6 rajonet e tjera gjatë vitit 2008. Duke filluar nga vitit 2009 e në vazhdim zhvillimi i panaireve të punësimit të bëhet në mënyrë të përhershme.

Zgjerimin e trajnimit të stafit fokusuar në përmirësimin e kapaciteteve të stafeve për të ofruar këshillim individual, kompetencë dhe vlerësim nevojash, dhe ndjekje e procesit për personat që regjistrohen

në SHKP. Kjo është mjaft e vërtetë për grupet në rrezik përjashtimi social dhe përjashtimi nga tregu i punës.

Rritja e rolit të partnerëve socialë në të gjitha nivelet e punës të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, (hartim, zbatim dhe monitorim i politikave dhe programeve) etj.

Rritja e rolit të partneritetit do të realizohet me amendim të bazës ligjore për të përmirësuar raportin e përfaqësimit në KAT në favor të partnerëve socialë.

Krijimi i një sistemi cilësor shërbimesh bën të domosdoshëm si më poshtë:

a) Krijimin e një sistemi informacioni të kompjuterizuar të shërbimeve të punësimit. Edhe pse janë realizuar disa skema pilot me ndihmën dhe mbështetjen e projekteve të ndryshme si ai i Bankës Botërore, UNOPS-it, ISCOS Marche etj., ende SHKP nuk ka një sistem të qëndrueshëm informatik të informacionit të tregut të punës.

Për realizimin e një objektivi të tillë, SHKP është duke zbatuar aktualisht një projekt me Bordin Kombëtar të Tregut të Punës së Suedisë, me titull: "Shërbime Punësimi Efiçente në Shqipëri", me financim të Qeverisë Suedeze. Objektivi kryesor i këtij projekti është krijimi i një sistemi të informatizuar të vendeve të lira të punës dhe Bankës së Punëkërkuesve të Papunë, duke pasur si opsion edhe Bankën e Punëdhënësve. Më shumë rreth zhvillimit të IT në sistemin e SHKP do të trajtohet në pikën 3 me temë: "Zhvillimi i IT në Shërbimet e Punësimit".

b) Trajnimin fillestar dhe të vazhduar të stafit të SHKP.

Gjatë viteve 2001-2006, trajnimi i stafit është bërë veçanërisht në partneritet të ngushtë me Agjencinë Kombëtare për Punësim të Francës, me ITAP, por kryesisht kjo gjë është bërë vetëm me stafin në nivel qendror dhe në disa zyra pilot, ndërsa niveli i trajnimit të stafit në zyrat lokale është akoma shumë i dobët.

Rezultatet e dukshme në përmirësimin e punës së shërbimeve të punësimit gjatë dekadës së fundit janë, si më poshtë:

- Riorganizimi i hapësirave të zyrave rajonale të punësimit sipas standardeve të vendeve të BE-së, ndërkohë që në zyrat vendore të punësimit, ambientet dhe infrastruktura është në nivel relativisht të ulët.

- Zbatimi i metodologjive të reja në shërbimet e punësimit, në mënyrë të veçantë zbatimi i metodologjisë së planeve të aksionit (përvoja nga eksperienca franceze), e cila do të ndihmojë në zbutjen e problemeve të tregut të punës. Kjo do të përbëjë bazën për të kaluar në planaksioni kombëtar për punësimin.

Objektivi strategjik për vitin 2007-2013, në fushën e shërbimeve të punësimit është modernizimi i shërbimeve duke e transformuar në mënyrë të vazhdueshme SHKP-në nga një institucion që ofron shërbime administrative në institucion që ofron shërbime ndaj dy klientëve kryesorë të saj, punëkërkuesve të papunë dhe biznesit.

Për realizimin e këtij objektivi duhet: i) të forcohet dhe zhvillohet institucionalisht sistemi i shërbimeve të punësimit; ii) të krijohet një sistem modern dhe unik i shërbimeve të punësimit në të gjithë vendin nëpërmjet përmirësimit dhe zhvillimit të metodës së punës dhe të kapaciteteve menaxheriale të stafit; iii) të rritet punësueshmëria dhe të ulet papunësia nëpërmjet aplikimit të politikave aktive të punësimit; iv) të ndërtohen dhe zhvillohen marrëdhënie të fuqishme të partneritetit me aktorë të tjerë që operojnë në tregun e punës e sidomos me partnerët socialë.

Nën objektivat që janë ndërmarrë dhe vazhdojnë të implementohen për realizimin e këtyre objektivat kryesorë mund të grupohen, si vijon:

A. Krijimi i një sistemi modern dhe unik i shërbimeve të punësimit në të gjithë vendin

a) Unifikimi i shërbimeve të punësimit dhe ngritja e nivelit të punës së specialistëve në punën me klientët, duke e përqendruar punën veçanërisht në zyrat lokale të punësimit, për t'i rritur edhe ato në nivelin e shërbimeve që ofrohen në ZRP.

b) Rishikimi i kapaciteteve, shpërndarjes dhe shtrirjes gjeografike të shërbimeve të punësimit. Rritja në zyrat e punësimit brenda stafit ekzistues të numrit të specialistëve që kryejnë shërbime me klientët dhe rregullimi i përpjesëtimeve ndërmjet punonjësve të shërbimeve dhe specialistëve të tjerë, në favor të të parëve. (Objektivi është të kalojmë nga 47 % në 55 % raportin e specialistëve që punojnë drejtpërdrejt me klientët).

Objektivi strategjik në lidhje me këtë çështje është menaxhimi më me efiçencë i burimeve ekzistuese njerëzore, duke parë mundësinë e hapjes së Agjencive të Shërbimeve në ato bashki ku niveli i popullsisë dhe i papunësisë e bën të domosdoshme një gjë të tillë.

c) Përmirësimi i mëtejshëm i monitorimit dhe vlerësimit të punës së shërbimeve të punësimit. Kjo do të realizohet në mënyrë më transparente pas instalimit të Bankës së vendeve të lira të punës dhe regjistrit të punëkërkuesve.

d) Rritja cilësore e studimit afatshkurtër të tregut të punës (kryhet çdo vit) ku përfshihet një panoramë e hollësishme e situatës së tregut të punës në të gjithë komponentët që ai përmban, një parashikim i ecurisë së tij, i cili do të përmbajë rrezikun e papunësisë, tendencat e punësimit, nevojat për formim. Në bazë të tyre do të parashikohen masat e nevojshme për ndërhyrje të mëtejshme në tregun e punës.

B. Ndërtimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve të partneritetit me aktorë të tjerë në tregun e punës

a) Për rritjen e bashkëpunimit me biznesin, duke qenë partnerë në veprimtarinë e tyre, punëdhënësit dhe zyrat e punësimit, kanë të drejta dhe detyra përkatëse, të cilat duhet t'i zhvillojnë në funksion të përmirësimit dhe ndërhyrjeve të mundshme të tregut të punës.

b) Bashkëpunimit me universitetet, INSTAT-in, me partnerët socialë, institucione studimore dhe donatorë të ndryshëm do t'i kushtohet më tepër vëmendje për studime dhe aplikime në fushën e tregut të punës, të ngritjes së kapaciteteve, të zhvillimit të burimeve njerëzore dhe formimit profesional.

C. Zhvillimi i teknologjisë të informacionit (IT) në shërbimet e punësimit si një faktor kyç për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve

Sot infrastruktura e përgjithshme e IT në SHKP dhe në zyrat e punësimit është krejt e pamjaftueshme dhe nuk ka një administrim qendror në lidhje me pajisjet e IT, që do të thotë që ka kushte të ndryshme në zyra të ndryshme. Nuk ka një buxhet të veçantë specifik për IT, prandaj një nga objektivat afatshkurtër të kësaj strategjie është krijimi i një sistemi informatik informacioni të tregut të punës. Futja e një sistemi teknologjie informacioni për të mbështetur informacionin e tregut të punës kërkon midis të tjerave edhe përmirësimin e cilësisë së të dhënave të grumbulluara nga intervistimet me punëdhënësit, pasi shpesh herë këto të dhëna ose informacione nuk janë gjithmonë të mjaftueshme dhe të besueshme etj.

Në këtë kontekst për zhvillimin e sistemit të IT, SHKP po zbaton projektin me titull: "Shërbime punësimi efiçente në Shqipëri" rezultati i pritshëm i zhvillimit të sistemit të IT në SHKP do të jetë: Krijimi i bankës së vendeve të lira të punës; bankës së punëkërkuesve të papunë deri në fund të vitit 2007 në Zyrat Qendrore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në zyrën rajonale pilot të Tiranës dhe Korçës.

Autputi kryesor i zbatimit të këtij sistemi informatik do të jetë:

a) shërbime më të mira për punëkërkuesit e papunë, duke iu ofruar një gamë të gjerë ofertash punësimit në shkallë republike (sistem informatik me akses interneti);

b) shërbime më të mira për punëdhënësit, duke i siguruar kandidatë të përshtatshëm për vendet e tyre të lira të punës.

Objektiv strategjik për SHKP për vitet 2006-2009, është shtrirja e sistemit të IT, në të gjitha zyrat e punësimit në vend.

Kjo do të realizohet si me mbështetje të mundshme të fondeve CARDS (2005-2006) të BE dhe me fonde të vëna në dispozicion nga Qeveria Shqiptare.

D. Përmirësimi i kontakteve me ndërmarrjet:

SHKP e ndërgjegjshme për rolin që ka biznesi në realizimin e misionit të saj, ka filluar prej disa vitesh nën asistencën e ekspertizës së huaj, përmirësimin e marrëdhënieve me biznesin. Këto marrëdhënie rregullohen nëpërmjet vizitave në ndërmarrje.

Analiza e gjendjes aktuale bën të domosdoshme, krijimin e një database (network) të vizitave në ndërmarrje, gjë e cila do të përmirësonte si të dhënat mbi ofertat e punësimit dhe plotësimin e nevojave të biznesit.

Në këtë drejtim Shërbimi Kombëtar i Punësimit, për të rritur efiçencën e shërbimeve të punësimit në raport me marrëdhëniet me ndërmarrjet do të punojë për:

- Përdorimin e metodës për të punuar me grupe të papunësh dhe për të strukturuar fluksin e punëkërkuesve të papunë dhe të ofertave të lira të punës në zyrat e punësimit. Kjo do të bëjë të mundur që specialistët e shërbimeve të përdorin më shumë kohë për të intensifikuar kontaktet me punëdhënësit dhe me grupet vulnerabël që kanë probleme specifike në tregun e punës.
- Intensifikimin, strukturimin dhe dokumentimin më të mirë të vizitave në ndërmarrje dhe intervistat e bëra, për të marrë informacionet e nevojshme për bankën e vendeve të lira të punës dhe për parashikimin e tregut të punës në mënyrë që të mbledhim informacionin e përshtatshëm për zhvillimin e modelit të menaxhimit me objektiva.

E. Zhvillimi i burimeve njerëzore

Trajnimi i stafit në nivel qendror është realizuar nëpërmjet trajnimeve të ITAP dhe trajnimeve që janë kryer në kuadër të bashkëpunimit me projektin francez (ANPE).

Për zhvillimin dhe trajnimin e stafit po punohet për të:

- Zhvilluar një model për të identifikuar nevojat për trajnimin e stafit;

- Zhvilluar një strategji për një organizim të trajnimit të stafit në shkallë kombëtare duke përfshirë një numër të pacaktuar formuesish ose trajnerësh, mbështetur edhe në eksperiencën franceze;

- Zgjeruar grupin e formuesve me specialistë të shërbimeve të punësimit, duke shfrytëzuar grupin aktual të formuar nga eksperienca franceze.

- Krijuar dhe aftësuar kapacitete për të ndërmarrë vrojtime, studime dhe parashikime mbi zhvillimet e tregut të punës, si dhe për të bërë analiza cilësore të elementeve të veçanta të tij.

3.3.2 Shërbimet private të punësimit

Shqipëria ka ratifikuar konventën nr.181 të ILO-s "Agjencitë private të punësimit" ku parashikohen aktivitetet që duhet të kryejë një agjenci private të punësimit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e klientëve të këtyre shërbimeve.

Duke filluar nga viti 1999, legjislacioni shqiptar lejon krijimin dhe funksionimin e Agjencive Private të Punësimit. Këto agjenci sigurojnë: i) shërbime që bëjnë vlerësimin e kërkesave dhe të aplikimeve për punësim brenda e jashtë shtetit; ii) shërbime që lidhen me kërkimin e punës; iii) shërbime për punësimin e punëtorëve, për t'u bërë të disponueshëm për një palë të tretë, person fizik ose juridik, i cili cakton detyra dhe kontrollon zbatimin e tyre.

Aktualisht funksionojnë 14 agjenci private punësimi. Aktiviteti disavjeçar i agjencive private është përqendruar kryesisht në punësimin e një numri të kufizuar personash, sidomos të atyre jashtë vendit.

Synimet kryesore për përmirësimin e situatës së agjencive private të punësimit në tregun e punës janë:

- rritja e bashkëpunimit të tyre me shërbimet publike të punësimit, duke synuar që agjencitë private të punësimit të interesohen që shërbimet e tyre t'i vënë në dispozicion edhe të tregut të brendshëm;

- kontroll më i rreptë në momentin e licencimit, me qëllim që ato që përfitojnë licencën të jenë të afta për të kryer shërbimet që u takojnë;

- në bashkëpunim me projektin e ILO/migranti të krijojë forumin e agjencive private të punësimit me qëllim që këto agjenci të adaptojnë një kod etik, të shkëmbejnë eksperienca. Në këtë forum do të bëjnë pjesë dhe përfaqësues të shërbimeve publike për orientimin dhe shkëmbimin e eksperiencës me këto agjenci private;

- në bashkëpunim me forumin e agjencive private të punësimit vendosja e mekanizmave monitorues për të garantuar që aktiviteti i agjencive private të punësimit të jetë transparent dhe shmangien e veprimtarisë trafikuese.

3.3.3 Programet e nxitjes së punësimit

Programet e nxitjes së punësimit u prezantuan për herë të parë në Shqipëri në vitin 1999.

Synimi kryesor i këtyre programeve është: i) krijimi i vendeve të reja të punës dhe ulja e nivelit të papunësisë; ii) formimi profesional i punëkërkuesve të papunë sidomos në ato zona ku mungojnë kapacitetet trajnuese; iii) ndihmë ndërmarrjes për të rritur aktivitetin e saj dhe të bëjë përzgjedhje më të mirë të fuqisë punëtore; iv) nxitja e drejtpërdrejtë e punësimit të një pjese të të trajnuarve; v) minimizimi i punës së zezë; vi) përfshirja në këto programe të punëkërkuesve të papunë përfitues nga skemat e mbështetjes me të ardhura me qëllim uljen e kostove të këtyre programeve; vii) nxitja e punësimit të të rinjve dhe grupeve të veçanta të të papunëve.

Programet e nxitjes së punësimit janë të vetmet programe aktive shtetërore, të cilat veprojnë drejtpërsëdrejti në grupin e punëkërkuesve të papunë për t'i nxitur ata në gjetjen e një punësimi sa më afatgjatë. Këto programe së bashku me programin e ndërmjetësimit në punë ndikojnë realisht në uljen e numrit të papunëve të regjistruar, si dhe çka është më e rëndësishme largimin e tyre nga skemat pasive të mbështetjes me të ardhura (pagesa e papunësisë dhe ndihma ekonomike).

Aplikohen aktualisht 5 programe dhe konkretisht:

1. Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë: Punëdhënësit që punësojnë me punësime të përkohshme (3-6 muaj) punëkërkues të papunë, mund të përfitojnë financim mujor të pagës së tyre deri në 100 % të pagës minimale, si edhe shpenzimet për sigurimet shoqërore të përfituesve. Nëse përfituesit punësohen për një periudhë deri në një vit dhe nëpërmjet kontratave të rregullta, punëdhënësi ka të drejtën të përfitojë një financim mujor të barabartë me shumën e një page minimale dhe kontributin për sigurimet shoqërore të detyrueshme për një periudhe deri në 5 muaj. Nëse përfituesi nuk ka formimin profesional përkatës për detyrën që ai ose ajo duhet të kryejnë, dhe punëdhënësi e ofron atë, ai mund të përfitojë një rritje prej 10-20 për qind të financimit për çdo përfitues.

2. Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë: ky program mbështet financiarisht punëdhënësit që sigurojnë trajnimin e përfituesve dhe që punësojnë një pjesë të të trajnuarve të paktën për një vit. Qeveria e mbështet financiarisht punëdhënësin në % të caktuara në lidhje me pagën dhe kontributin e sigurimeve shoqërore gjatë nëntë muajve të trajnimit. Pas përfundimit të kurseve të trajnimit, punëdhënësi

është i detyruar të punësojë 40 për qind të të trajnuarave.

3. Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit institucional programi për nxitjen e punësimit nëpërmjet formimit institucional: Zyrat e punësimit caktojnë dhe sigurojnë trajnimin për përfituesit nga ato kompani që: i) garantojnë punësimin pas përfundimit të trajnimit; ose ii) mund të tregojnë nëpërmjet studimeve dhe investigimeve të tregut të punës se trajnimi do të jetë i dobishëm për pjesëmarrësit. Ata përfitues që refuzojnë të marrin pjesë në këto kurse hiqen nga lista e punëkërkuesve të papunë dhe u ndërpritet pagesa e papunësisë.

4. Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra synon të integrojë në tregun e punës gra të margjinalizuara si gratë rome, ish-të trafikuara, gra të moshuara dhe gra invalide. Ky zgjat nga një deri tre vjet. Gjatë vitit të parë, punëdhënësi mund të përfitojë 75 për qind të financimit për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe 4 paga minimale. Gjatë vitit të dytë, punëdhënësit marrin 85 për qind të kontributit për sigurimet shoqërore dhe 6 paga minimale dhe gjatë vitit të tretë ata marrin 100 për qind të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe 4 paga minimale.

5. Për herë të parë do të zbatohet në vitin 2007, programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet përfshirjes së tyre në programet e praktikave profesionale në institucione/ndërmarrje, publike apo private punëdhënësit publikë janë të detyruar t'i marrin falas në mjediset e tyre këta punëkërkues, në raport me personelin e administratës, sipas skemës: për çdo 50 veta personel – 1 praktikant. Për punëdhënësit privatë, që pranojnë në mjediset e tyre punëkërkues të papunë, të përfshirë në këtë program, përfitojnë një financim mujor nga zyra përkatëse e punësimit, në masën 100 për qind të nivelit bazë të pagesës së papunësisë, për çdo muaj praktikë të punëkërkuesit. Të njëjtën masë financimi marrin edhe punëkërkuesit e papunë që përfshihen në këtë program.

Për programet e sipërpërmendura nga ministria për herë të parë në vitin 2004 vendosi prioritetet vjetore të zbatimit të tij ku përparësi i jepet zbatimit të atyre programeve që sigurojnë punësim sa më afatgjatë, programit të punësimit të punëkërkueseve të papuna femra, punësimit të grupeve të veçanta, aplikuesve nga ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Këto prioritete vendosen çdo fillim viti në bazë të analizës që i bëhet programit në vitin paraardhës nevojave të punëkërkuesve të papunë apo grupeve të veçanta. Në bazë të prioriteteve bëhet dhe ndarja e fondeve sipas programeve.

Një hap i rëndësishëm për përmirësimin e zbatimit të këtyre programeve është miratimi i akteve nënligjore për monitorimin dhe mbikëqyrjen e programit nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe ministria. Rritja e kontrollit kundër abuzimeve si nga strukturat e SHKP ashtu dhe ndaj subjekteve aplikuese. Mbas këtyre proceseve, do të ndërhyhet për përmirësimin e programe ekzistuese të nxitjes së punësimit dhe hartimit të programeve të reja, për t'i përshtatur ato me zhvillimet e tregut të punës.

Për kryerjen e një analize realiste, sipas standardeve të vendeve të BE-së dhe ILO, do të realizohet për periudhën 2007-2013:

a) analizë vjetore mbi efektshmërinë e programeve të nxitjes së punësimit, si një kusht paraprak për përcaktimin e prioriteteve për vitin në vazhdim;

b) analizë dhe monitorim nga institucione ndërkombëtare si BE dhe ILO, të ecurisë së programeve me synim përmirësimin e zbatimit të tyre në të ardhmen;

c) në një periudhë afatgjatë, propozojmë monitorimin e këtyre programeve nga ekspertizë e pavarur e akreditуar dhe certifikuar për realizimin e një misioni të tillë.

Do të vazhdojë procesi i vendosjes së prioriteteve nga ministri, të lidhura këto me situatën në tregun e punës dhe drejtimet e zhvillimit. Në vendosjen e prioriteteve do të vlerësohet rekomandimi i CREP për prioritete të kufizuara dhe të monitorueshme. Vendosja e prioriteteve është e lidhur me ndarjen e fondeve sipas programeve dhe grupeve që trajtohen.

Rëndësia dhe cilësia e politikave aktive të punësimit duhet të vlerësohet rregullisht. Prandaj, është e nevojshme siç u tha më sipër të ndërtohen mekanizma për të monitoruar e më pas vlerësuar këto politika duke angazhuar edhe partnerët socialë. Kjo mund të çojë në përmirësimin në të ardhmen të programimit, e informimit, instruktimit më të qartë të stafit të zyrave lokale të punësimit. Vlerësimi i programeve duhet të bëhet nga institucione të specializuara për këtë qëllim.

Për këtë brenda fondeve të programeve të nxitjes së punësimit duhet të parashikohet një zë për vlerësimin e projekteve të nxitjes së punësimit nga institucionet përkatëse.

Informimi mbi politikat aktive ekzistuese është një element i rëndësishëm parandalues.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit duhet të ndërmarrë veprime nxitëse më aktive për tregun e punës si një garanci transparence për individët dhe ndërgjegjësimin në rritje për mundësitë ekzistuese.

Informacioni i tregut të punës duhet të përmirësohet me qëllim që në bazë të këtij informacioni të bëhen studime në lidhje me fuqinë punëtore. Kjo do të ndihmojë në vlerësimin e programeve të nxitjes së

punësimit dhe vendosjen e prioriteteve çdo fillim viti.

Hartimi i një politike aktive që synon të merret me të rinjtë në pozita të disfavorshme të cilët, p.sh. kombinojnë trajnimin me punësimin e subvencionuar për herë të parë dhe udhëzimet e këshillimit për formim profesional me programet e biznesit për të rinjtë.

Praktikat profesionale do të jetë një program i ri në tregun e punës. Ky program do të fokusohet në kategorinë e të rinjve, të cilët sapo kanë mbaruar studimet e tyre universitare apo të mesme si brenda ashtu dhe jashtë vendit dhe gjenden të papunë, si pasojë e mungesës së eksperiencës në punë. Për këtë arsye këta të rinj do të përfshihen në programe praktikash profesionale (stazhe) në ndërmarrje apo institucione qofshin këto private apo publike. Të rinjtë do të kenë mundësi që të përfitojnë eksperiencën e duhur për të pasur më tej një punësim sa më afatgjatë. Institucionet shtetërore/publike do t'i pranojnë falas punëkërkuesit e papunë të sapodiplomuar. Ndërsa këta të fundit do të marrin një mbështetje financiare (në nivelin e pagesës së papunësisë). Fillimisht programi do të pilotohet te të rinjtë të cilët kanë mbaruar arsimin e lartë brenda fondeve të parashikuara në buxhetin afatmesëm dhe më pas me sigurimin e fondeve shtesë do të synohet shtrirja e programit te të rinjtë që mbarojnë arsimin e mesëm. Për vitin 2007 parashikohet trajtimi i rreth 150 punëkërkuesve të papunë të sapodiplomuar me 10 milionë lekë nga buxheti i shtetit për programet e nxitjes së punësimit.

Përveç programit të praktikave profesionale i cili do të jetë një program i ri në tregun e punës në lidhje me nxitjen e punësimit të të rinjve synohet:

1. zbatimi në vazhdim i programeve e nxitjes së punësimit ku përparësi do t'u jepet të rinjve dhe grave;
2. zbatimi me efikasitet i programit të këshillimit për punë dhe profesion, duke përfshirë këtu programet e lëvizshme të këshillimit në shkolla, universitete dhe në zyrën e punësimit;
3. për grupet e veçanta të të rinjve do të merren masa në lidhje me formimin profesional të tyre me tarifa të reduktuara ose falas në qendrat publike të formimit profesional.

Një program tjetër në tregun e punës do të jetë ai për **personat me aftësi të kufizuar (PAK).** Qëllimi i këtij programi është që në zbatim të ligjit të nxitjes së punësimit (neni 17), të rregullojë detyrimin e punëdhënësit për të punësuar PAK dhe në rastet kur ai nuk e bën këtë të derdhë në fondin e SHKP një pagë minimale për çdo person që nuk ka punësuar.

Fondet e grumbulluara do të përdoren për hapjen e vendeve të reja të punës për këta persona. Format e mbështetjes do të jenë: i) financime në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi dhe sigurimeve të detyrueshme për çdo të punësuar; ii) subvencione për pajisjen apo përshtatjen e vendit të punës; iii) pagesa e tarifave për formimin nëpërmjet punës; iv) hapje e vendeve të punës të mbrojtura ku punësohen persona me aftësi të kufizuar (atelie dhe qendra punësimi të përbashkëta).

Në bazë të kësaj strategjie dhe Strategjisë Kombëtare të PAK objektivat në fushën e arsimit dhe punësimit dhe formimit profesional janë:

1. përmirësimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve për punësimin e PAK;
2. përmirësimi i politikave dhe programeve për trajnimin dhe formimin profesional të PAK;
3. rritja mundësive për punësim të PAK dhe rritja e mundësive për arsim dhe formim profesional në mënyrë që të rriten kapacitetet e tyre individuale për punësim;
4. inkurajimin e personave me aftësi të kufizuara për zhvillimin e mundësive mbështetëse për punësim dhe formim profesional;
5. informimi dhe edukimi i punëdhënësve për mundësitë e personave me aftësi të kufizuar për të punuar;
6. sigurimi i informacionit për mundësitë e karrierës, mënyrave si të krijojnë të ardhura dhe për ndihmën e nevojshme që duhet t'u jepet personave me aftësi të kufizuara;
7. të sigurohet që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë të njëjtat kushte punësimi, të drejta dhe privilegje, si gjithë të tjerët, duke përfshirë dispozitat për pagesë minimale për punë me prodhimtari të krahasueshme.

Punët publike

Aktualisht janë duke u implementuar disa tipa të tjerë programesh pilot për punët publike duke shfrytëzuar fondet e programit për ndihmë ekonomike. Punët publike zakonisht shihen si lehtësime të varfërisë dhe përfitime për komunitetin, por nuk i përmirësojnë shanset për ripunësimin e të papunëve pjesëmarrës. Megjithatë, punët publike mund të funksionojnë mjaft mirë për punësimin e punëkërkuesve të papunë të komunitetit rom. Një gjë e tillë është parashikuar në strategjinë përkatëse.

Është e rëndësishme që programet për punët publike të shoqërohen me politika të tjera aktive, si p.sh., zhvillimin e aftësive dhe këshillimin profesional të cilat përmirësojnë aftësinë për punësim të

pjesëmarrësve duke rritur shansin të gjejnë punë me të mbaruar programin e punëve publike.

Barazia gjinore dhe shanset e barabarta

Në drejtim të përmirësimit të nivelit të punësimit ministria ka ndërmarrë një sërë masash për punësimin e femrave: kështu është zbatuar për herë të parë në vitin 2004 programi i nxitjes së punësimit të femrave ku prioritet i jepet grupeve të veçanta të femrave si viktimat e trafikut, me aftësi të kufizuar, femra rome mbi 35 vjeç, vajza nëna, femra të divorcuara me probleme sociale. Aktivitetet e mësipërme kanë qenë të bashkërenduara ngushtësisht me Zyrën e Koordinimit Kombëtar të Antitrafikimit në Ministrinë e Brendshme. Gjatë vitit 2006 nëpërmjet këtij programi janë punësuar 1053 punëkërkues të papunë femra nga të cilat 649 nga grupet e veçanta. Gjithashtu, për herë të parë është aplikuar në vitin 2004 lehtësimi i tarifave të sistemit të formimit profesional për gratë dhe vajzat në Qendrat Publike të Formimit profesional. Nëpërmjet këtij programi kanë përfituar:

- tarifa falas 24 punëkërkuese të papuna femra;
- tarifa të reduktuara 369 punëkërkuese të papuna femra.

Janë licencuar 150 subjekte private që ofrojnë kurse kryesisht për profesione që aftësojnë gratë dhe vajzat; hapjes së qendrave të punësimit për gratë e vajzat nga OJF-të, si në Tiranë, Elbasan, Berat etj., hapjen e disa qendra informimi dhe ndërmjetësimi etj.

Gjithsesi, Shërbimi Kombëtar i Punësimit duhet të sigurojë masat për mbikëqyrjen e mundësive dhe trajtimin e barabartë midis burrit dhe gruas në fushën e shërbimeve të punësimit, formimit profesional, si dhe në mbështetjen me të ardhura në rast papunësie.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për rritjen e barazisë gjinore në punësim, të shikohet mundësia e rritjes së kapaciteteve në shkollat e mesme profesionale, në degë të përshtatshme për femra si konfeksion, hoteleri-turizëm, ekonomik etj., dhe hapjes së degëve të reja.

Synimet kryesore të integrimit gjinor kjo në kuadrin e nënshkrimit të konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare si Konventa e të Drejtave të Njeriut CEDAW, platforma për veprim e Pekinit, OZHM-të janë:

- vazhdimi i zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit të femrave;
- vazhdimi i zbatimit të programit të aplikimit të tarifave falas apo të reduktuara për femrat;
- pjesëmarrja aktive e grave, përfaqësuese të OJF-ve dhe të gjithë grupeve të synuara për formulimin e politikave, garantimin e përgjegjësive dhe nevojave për grupet shoqërore më të diskriminuara;
- përdorimi i statistikave dhe të dhënave sipas seksit, duke përdorur formularë më të detajuar që të evidentohen të dhënat në bazë të përkatësisë gjinore;
- të dhënat duhet të plotësohen dhe të mblidhen nga të gjitha njësitë zbatuese të rajoneve të vendit, me qëllim pasurimin e të dhënave në nivel kombëtar;
- buxhetimi gjinor të bëhet mbi bazën e përfitimeve të barabarta gjinore. Kjo të bëhet pas raportimeve të deritanishme për të hartuar edhe politika jo vetëm kontribuese, por edhe përfituese të barabarta.

Politika të veçanta do të ndiqen për grupet e grave në nevojë. Përveç politikave të përmendura më sipër do të ketë politika të reja në lidhje me:

- gratë kryefamiljarë, viktimat e trafikut do të merren masa për sigurimin e formimit profesional pranë qendrave publike të formimit profesional (shërbimi është falas), si dhe masa punësimin e tyre. Kjo bëhet gjithashtu për parandalimin e fenomenit të trafikimit;
- për gratë e komunitetit rom dhe egjiptian do të punohet për ndërgjegjësimin e punonjësve të zyrave të punësimit, për zbatimin e programeve ekzistuese të nxitjes së punësimit për këto grupe (vendimin e Këshillit të Ministrave nr.632), si dhe masat e parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Integrimin e Komunitetit Rom.

Punësimi dhe formimi profesional për komunitetin rom

Një pjesë e madhe e të papunëve dhe persona joaktivë të minoritetit rom kanë qenë të papunë për një periudhë disa vjeçare, dhe midis tyre pjesa më e madhe nuk janë në gjendje që të gjejnë punë.

Arsye kryesore për nivelet e larta të papunësisë afatgjatë të komiteti rom lidhet me: i) mungesën e shkollimit; ii) disavantazhet rajonale; iii) diskriminimin; dhe iv) efiçencën e ulët të politikave aktive të punësimit të Komunitetit të Romëve, për shkak se pjesa më e madhe e tyre nuk janë të regjistruar si të papunë.

Formimi profesional falas apo me tarifa të reduktuara është një nga prioritetet e ministrisë për rritjen e shanseve të punësimit të këtij komuniteti.

Gjithashtu, një hap i rëndësishëm është: i) identifikimi i profesioneve që mund të mësohen nga romët; dhe ii) hapja e kurseve të formimit profesional për profesionet e identifikuara në qendrat publike dhe

private të formimit profesional.

Vendosja nga ana e zyrave të punësimit të lidhjeve me të papunët e komunitetit rom (jo vetëm atyre që janë të regjistruar në këto zyra).

Aktivizimi i programit të punëve publike, për të hapur vende pune për punëkërkuesit e papunë romë që nuk kërkojnë kualifikime.

Zbatimi i programeve speciale ekzistuese (në mënyrë të veçantë vendimi i Këshillit të Ministrave nr.632) për nxitjen e punësimit për komunitetin rom.

Gjithashtu, përdorimi i politikave lehtësuese për kompanitë që punësojnë anëtarë të komunitetit rom synon: i) mundësinë e financimit të kompanive ku punëdhënës dhe punëmarrës janë nga komuniteti rom; ii) krijimin e lehtësirave fiskale për ato kompani që hapin vende pune për romët; si dhe iii) mbështetjen me bazë materiale, ambiente, mjete financiare dhe burime njerëzore për ato biznese që kanë si destinacion produktet e traditës rome.

Punësimi dhe formimi profesional për fëmijët që punojnë në mënyrë informale

Një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve që punojnë vijnë nga familje ku prindërit janë të papunë dhe të pakualifikuar duke u bërë ata mbajtësit kryesorë të familjes. Do të kishte një ndikim të dukshëm në zbutjen e fenomenit të punës së fëmijëve:

- aplikimi i programeve të formimit profesional për fëmijët që punojnë dhe që e kanë mbushur moshën ligjore me tarifa të reduktuara ose falas në qendrat publike të formimit profesional;
- rritja e mundësive për punësim të prindërve apo anëtarëve të rritur të familjeve të fëmijëve që punojnë, duke nxitur dhe kushtëzuar kthimin e tyre në shkollë;
- informimi i komunitetit mbi mundësitë e formimit profesional dhe punësimit që ofrohen nga drejtoritë rajonale të formimit profesional dhe zyrat e punësimit;
- nxitja e programeve për krijimin e mundësive për punësim të personave që kanë shkallë arsimimi dhe kualifikimi të ulët;
- institucionalizimi i bashkëpunimit në nivel lokal për adresimin e drejtë të çështjes së punës të fëmijëve dhe referimin e tij.

Politikat për punësimin dhe formimin profesional të emigrantëve potencialë dhe atyre të kthyer

Shumë nga aspektet që lidhen me formimin profesional dhe punësimin e emigrantëve potencialë dhe atyre të kthyer trajtohen nga strategjia kombëtare për migracionin, një nga dokumentet politike me adekuate dhe konform standardeve europiane në lidhje me menaxhimin e emigracionit[3]. Analiza e mëposhtme ndjek dy nënndarje kryesore; emigrantët potencialë dhe emigrantët e kthyer[4]. Kjo nënndarje bëhet për të marrë në konsideratë ndryshimet në nevoja/kërkesa të këtyre dy grupeve.

Emigrantët potencialë

Marrja e masave me qëllim reduktimin e fluksit të migracionit kryesisht në zonat rurale nëpërmjet krijimit të lehtësirave për gjallërimin e sektorit bujqësor në vend. Për këtë janë propozuar këto masa:

i) hartimi i një raporti vlerësues mbi emigrimin në zonat rurale dhe identifikimi i zonave më emergjente për gjallërimin e sektorit bujqësor në vend;

ii) rishikimi i strategjisë për zhvillimin rural, me qëllim nxitjen e punësimit në sektorin bujqësor.

Zhvillimi i politikave me qëllim shmangien e largimin të trurit nëpërmjet:

i) rritjes së ofertës për punë në Shqipëri;

ii) tërheqja e investitorëve të huaj dhe nxitja e investitorëve që të punësojnë staf në vend, ose nga diaspora jashtë vendit.

Ngritja dhe caktimi i sporteleve të migracionit në cilësinë e institucionit që do të merret me dhënien e informacionit për migracionin. Për këtë duhet të krijohet infrastruktura e nevojshme në zyrat rajonale të punësimit, duke përshirë: pajisjen me kompjutera dhe trajnimin e personelit.

Ofrimin e informacionit lidhur me shërbimet e formimit profesional që u mundësohen emigrantëve potencialë përpara emigrimit nga zyrat e punësimit. Për këtë arsye një përfshirje më e gjerë e ministrisë del e nevojshme, për të planifikuar formimin profesional që mund t'i ofrohen kësaj kategorie si dhe për t'u përfshirë në fushatën publicitare të parashikuar në aktivitetin e tretë.

Duke qenë se strategjia e emigracionit parashikon masa për ngritjen e kapaciteteve të zyrave të punësimit për t'u ofruar shërbime sa më efektive emigrantëve potencialë dhe atyre të kthyer është e

[3] E hartuar nga Qeveria Shqiptare në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombetare për Migracionin dhe me suportin e Delegacionit të Komisonit Europian në Tiranë dhe e miratuar në nëntor 2004.

[4] Kjo Strategji trajton edhe aspekte të Strategjisë së Punësimit dhe Formimit Profesional dhe për këtë arsye analiza e kësaj të fundit do të trajtohet brenda kuadrit të Strategjisë për Migracionin.

nevojshme që të ndërmerret një studim i nevojave për trajnim/ngritje kapacitetesh të stafit të Zyrave Rajonale të Punësimit[5]. Identifikimi i nevojave do të ndihmonte më pas ngritjen e kapaciteteve përmes fondeve të MPÇSSHB si dhe donatorëve të tjerë.

Politikat për emigrantët e kthyer

Hartimi i një raporti vlerësues mbi mundësitë e formimit profesional që ofrohen aktualisht për emigrantët e kthyer dhe mbi nevojat dhe mangësitë ekzistuese.

Zgjerimi i shërbimeve riintegruese në mënyrë që të garantohet kthimi i qëndrueshëm nëpërmjet: i) hartimit dhe zbatimit të programeve të përbashkëta të punësimit me bizneset private; ii) ofrimit të shërbimit të këshillimit për karrierën, hyrjen në punë, dhe formimit profesional.

Ngritja e kapaciteteve të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrave të saj, lokale dhe rajonale dhe hartimi i programeve specifike për trajnimin lidhur me asistencën për të kthyerit.

Zhvillimi i politikave të reja, me qëllim nxitjen e kthimit të emigrantëve të kualifikuar, nëpërmjet: i) vlerësimit të ofertës dhe kërkesës për personel të kualifikuar, në tregun e punës shqiptar; ii) krijimit të kontakteve ndërmjet emigrantëve dhe ndërmarrjeve të mëdha në Shqipëri, duke krijuar një bankë të dhënash elektronike me ndërmarrjet dhe CV e emigrantëve.

3.3.5 Përmirësimi i klimës së biznesit dhe aksionet për SME-të

Zhvillimi i sektorit SME, konsiderohet si mjeti më efikas për ekonomitë në tranzicion që gjeneron rritje ekonomike të qëndrueshme, punësim dhe zbutje të varfërisë. Gjatë tre viteve të fundit Shqipëria ka përjetuar një rritje ekonomike prej 6%, një rritje kjo e vlerësuar si ndër më të mirat në rajon. Pa dyshim që sektori i SME-ve ka një kontribut të patjetërsueshëm në këtë proces. Kontributi i sektorit SME vlerësohet se siguron rreth 64% në PBB, si dhe punësimin e rreth 66% e të punësuarve në sektorin privat.

Përsa i takon shpërndarjes gjeografike të bizneseve në Shqipëri, rreth 50% e ndërmarrjeve aktive janë përqëndruar në zonën Tiranë–Durrës, ku janë punësuar 57% e të punësuarve te sektori privat. Rreth 69% e ndërmarrjeve me kapital të huaj janë të përqëndruar në prefekturën e Tiranës, rreth 5% në Korçë, rreth 5% në Shkodër dhe 3% në Vlorë.

Shpërndarja gjeografike e ndërmarrjeve aktive dhe të punësuarve për vitin 2005



Shpërndarja e bizneseve sipas sektorëve të ekonomisë, pra sektorët ekonomik në të cilët biznesi privat është më aktiv, janë tregtia (me 49%), shërbimet (me 24%), industria (me 11%) dhe transporti (me 10%).

[5] Në kuadër të një projekti të IOM për implementimin e Marrëveshjes së Ripranimit Shqipëri/BE është parashikuar kryerja e një vlerësimi të kapaciteteve të Zyrave Rajonale të Punësimit dhe më pas ngritja e kapaciteteve përmes trainimit dhe suportit material për zyrat rajonale në Tiranë, Durrës dhë Vlorë.

Grafiku 2 : Shpërndarja e ndërmarrjeve aktive sipas aktivitetit ekonomik për vitin 2006



Gjatë periudhës 2005- 2006 janë marrë një sërë politikash liberale në fushën e taksave për lehtësimin e barrës fiskale për bizneset e konkretisht:

- reduktimi i tatim fitimit për kompanitë nga 23% në 20%;
- reduktimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël nga 3% në 1,5% dhe reduktimi i taksës vendore mbi biznesin e vogël në masën 50%;
- heqja e tatimit mbi vlerën e shtuar për librin në shtëpitë botuese;
- heqja e tatimit mbi vlerën e shtuar për reklamat;
- ulja e barrës fiskale për tatimet për sigurimet shoqërore për punëdhënësit me 9 pikë (nga 29% në 20%);
- ulja e çmimit të energjisë elektrike për bizneset me rreth 30%.

Masat e përmendura më poshtë do të jenë pjesë e programit strategjik për zhvillimin e SME-ve për periudhën afatmesme 2007–2009 (në proces) si pjesë integrale e programit të qeverisë, që reflektohet në strategjinë e zhvillimit të biznesit dhe investimeve për periudhën afatmesme dhe afatgjatë 2007–2013.

Më konkretisht tre nivelet e mëposhtme janë të harmonizuara, si vijon:

1. Nivel Strategjik:

a) krijimi i komitetit konsultativ për zhvillimin e SME-ve;

b) hartimi i programit strategjik për zhvillimin e SME-ve (plan veprimi).

2. Nivel institucional (institucione mbështetëse Albinvest, rrjeti i agjencive rajonale të zhvillimit, agjencitë e zhvillimit ekonomik lokal, agjenci konsulence etj.).

3. Nivel ndërmarrje (sipërmarrësit dhe organizatat e biznesit).

Objektivi i përgjithshëm i këtij programi strategjik është zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i sektorit privat nëpërmjet rritjes së numrit të ndërmarrjeve të reja, si dhe përmirësimit të vazhdueshëm të treguesve produktivitetit, konkurrueshmërisë, si dhe të eksportit të ndërmarrjeve me potencial internacionalizimi.

Objektivat specifikë që do të shërbejnë në arritjen e këtij objektivi të përgjithshëm janë, si më poshtë:

A. Nxitja e kulturës së sipërmarrjes nëpërmjet:

1. krijimit të përmirësimit të aftësive menaxhuese dhe trajnuese;
2. rritjes së kualifikimit të fuqisë punëtore.

Përfshirja në kurrikulin e shkollave të mesme profesionale dhe qendrave publike të formimit profesional i njohurive për SME, si dhe përfshirja e gjuhës angleze në shkollat dhe qendrat e mësipërme (anglishtja e profesionit) do të ndikonte në rritjen e kulturës së sipërmarrjes.

B. Zhvillimi i bizneseve në rritje me kapacitet internacionalizimi:

1. përmirësimi i klimës së biznesit për zhvillimin e SME-ve;
2. rritja e konkurrueshmërisë nëpërmjet inovacionit dhe transferimit të teknologjisë.

C. Përmirësimi i financimit të SME-ve:

1. rritja e nivelit të kreditimit dhe krijimi i fondit shqiptar të garantimit të kredive;
2. rritja e fondeve për mikrokredi;
3. forcimi i kapaciteteve të institucioneve të mikrokredisë.

Gjithashtu, në këtë drejtim do të punohet për të rritur efektivitetin e inkubatorëve të biznesit në

qytetin e Tiranës dhe të Shkodrës dhe do të shihet mundësia e shtrirjes së tyre në rajone të tjera.

3.3.6 Programet pasive –pagesa e papunësisë

Pagesa e papunësisë jepet deri në një vit për personat të cilët kanë derdhur kontributet për të paktën 12 muaj. Për të nxitur trajnimin gjatë periudhës së papunësisë pagesa e papunësisë mund të shtyhet deri në 18 muaj me kusht që të mos marrin pagë apo përfitim tjetër gjatë periudhës së trajnimit.

Konventa e IlO-s nr.168 mbi: "Nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen nga papunësia" është ratifikuar tashmë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Në këtë kontekst, janë bërë dhe miratuar disa ndryshime në ligjin "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe në ligjin "Për nxitjen e punësimit", me synim që legjislacioni shqiptar të jetë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga konventa nr.168. Gjithashtu, në zbatim të ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave i cili rregullon skemën e pagesës së papunësisë.

Në konventën nr.168 është parashikuar që masa e pagesës së papunësisë të jetë 50% e masës së pagës minimale në shkallë vendi. Që të arrihet kjo duhet që pagesa e papunësisë të rritet gradualisht dhe paralelisht me pagën minimale në shkallë vendi.

Nga studimi i fundit i tregut të punës i bërë nga SHKP, për vitet në vazhdim, tendenca e papunësisë nuk do të ketë ndonjë rritje të konsiderueshme, pasi pak janë degët e ekonomisë që do të ristrukturohen ose do të privatizohen.

Në skemën e pagesës së papunësisë peshën specifike më të madhe e ka aktiviteti privat, si dhe privatizimi i KESH-it dhe Telekom–it (pas afatit 2 vjeçar), aeroporti Rinas, ndërmarrje ujësjellësi etj.

3.3.7 Arsimi dhe formimi profesional

Objektivat e mëposhtme të AFP marrin në konsideratë zhvillimet e kohëve të fundit, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon e më gjerë, si dhe iu referohen dokumenteve ndërkombëtare të rëndësishme që lidhen me veçoritë e sektorit të AFP. Ato janë në përputhje të plotë dhe me angazhimet e programit CARDS të BE i cili mbështet reformimin e AFP në Shqipëri edhe për vitet e ardhshme.

Rritja e fleksibilitetit të ofertës, mundësive të pranimit, përparimit dhe mobilitetit vertikal e horizontal në AFP, do të arrihet nëpërmjet:

a) krijimit të një kuadri kombëtar të kualifikimeve profesionale (KKKP);

b) ristrukturimit të niveleve të AFP duke u bazuar në KKKP;

c) krijimit të një cikli të veçantë për të plotësuar kulturën e përgjithshme të nxënësve që mbarojnë nivelin e punëtorit të kualifikuar, për të ofruar diplomën e maturës profesionale;

d) krijimit të një cikli postsekondar me orientim profesional për nxënësit që mbarojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe kërkojnë të marrin një kualifikim profesional.

Modernizimi i modelit kurrikular për ta afruar me kërkesat e botës së punës dhe për të rritur shkallën e fleksibilitetit do të arrihet nëpërmjet:

a) Institucionalizimit të një strukture kurrikuli të AFP dyshkallëshe me skeletkurrikula (si standard kombëtar) të hartuara në nivel qendror dhe kurrikula në nivel shkolle/qendre, të bazuara në skeletkurrikulat përkatëse, kërkesat reale të tregut rajonal të punës dhe mundësitë konkrete të shkollës/qendrës.

b) Modularizimit gradual të kurrikulit të AFP për të lehtësuar integrimin e kompetencave e standardeve të profesionit dhe për të mundësuar akumulimin, transferimin dhe njohjen e krediteve të fituara me mënyra dhe forma të ndryshme.

c) Institucionalizimit të një metodologjie të hartimit të kurrikulave të AFP që bazohet në analizën e profesioneve, që e konsideron hartimin e kurrikulit si një proces të vazhdueshëm e shumëshkallësh dhe angazhon të gjithë të interesuarit në këtë proces.

d) Mbështetjes së kurrikulit të AFP me "tekste integrale" që përdoren për një kohë relativisht të gjatë, nga një numër i madh përdoruesish jo vetëm të një niveli apo drejtimi profesional, duke ulur ndjeshëm kostot e prodhimit të tyre.

Zhvillimi i mekanizmave institucionalë për kryerjen e funksioneve të reja dhe mbështetjen e funksioneve aktuale në AFP do të arrihet nëpërmjet:

Fuqizimit të rolit të Këshillit Kombëtar të AFP (komisioneve të specializuara dhe sekretariatit të tij) si një organizëm këshillimor trepalësh (qeveri, punëdhënës, punëmarrës), në mbështetje të zhvillimit të politikave reformuese të AFP.

a) Krijimit të Agjencisë Kombëtare të AFP për të kryer funksione ndërsektoriale që aktualisht nuk mbulohen nga dikasteret dhe institucionet e AF.

b) Fuqizimit të bordeve të shkollave/qendrave me partnerë socialë (punëdhënës e punëmarrës).

c) Krijimit të departamenteve (mbi baza profesionale) në shkolla/qendra, si njësi të zhvillimit dhe përshtatjes së kurrikulave në nivel shkolle, si dhe të trajnimit të brendshëm të mësuesve dhe instruktorëve.

d) Krijimit të një mekanizmi kombëtar për orientimin profesional dhe këshillimin për karrierën, me

mbështetjen edhe të partnerëve socialë.

Zhvillimi i kompetencave mësimdhënëse dhe menaxhuese të personelit të AP do të arrihet nëpërmjet:

a) krijimit të një mekanizmi institucional për kualifikim (pre-service) për bazat e pedagogjisë dhe psikologjisë, të mësuesve dhe instruktorëve të rinj të AFP;

b) fuqizimit të mekanizmave institucionalë aktualë (në nivel qëndror dhe nivel shkolle) për trajnimin e vazhduar (in-service), metodik dhe profesional, të të gjithë mësuesve e instruktorëve të AFP.

c) Fuqizimit të mekanizmave institucionalë aktualë për trajnimin e drejtuesve të shkollave/qendrave në lidhje me veçoritë e menaxhimit në sektorin e AFP.

Plotësimi i kuadrit ligjor-normativ të AFP në mbështetje të të gjitha ndryshimeve reformuese në këtë sektor do të arrihet nëpërmjet:

a) Hartimit të një akti të posaçëm për "Kuadrin Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale" si dhe i akteve të tjera nënligjore në mbështetje të këtij komponenti të rëndësishëm për një sistem modern të AFP.

b) Krijimit të një kuadri ligjor-normativ më të përshtatshëm për zhvillimin e AFP jopublik.

c) Krijimit të një kuadri ligjor-normativ që lejon angazhimin më të madh të shkollave/qendrave në veprimtari ekonomike, me qëllim rritjen e cilësisë së përgatitjes dhe krijimin e të ardhurave shtesë dhe në fushën e formimit profesional përmirësimin e skemës së financimit nga financimi për inpute drejt financimit për outpute.

d) Akte të tjera ligjore dhe nënligjore në mbështetje të zhvillimeve në sistemin e AFP.

Zhvillimi sasior dhe cilësor i objekteve, mjediseve dhe mjeteve mësimore në mbështetje të rritjes së parashikuar cilësore dhe sasiore të ofertës së AFP do të arrihet nëpërmjet:

a) Rinovimit të mjediseve ekzistuese për mësimin teorik e praktik në shkolla/qendra, duke treguar kujdes për personat me aftësi të kufizuar.

b) Pajisjes me bazën e nevojshme materiale/didaktike për mësimin teorik e praktik.

c) Krijimit të shkollave/qendrave të reja, shndërrimit të disa shkollave të përgjithshme në shkolla profesionale, si dhe krijimit të qendrave të trajnimit ambulante (lëvizëse) në ato rajone ku kërkesa është më e ndjeshme. Këto do të shoqërohen edhe me ndërhyrje të tjera si ristrukturime ndërtesash, krijim repartesh pune të reja dhe pajisje të atyre ekzistuese, rishikim i kualifikimeve që ofrohen, etj. Në këtë drejtim t'i jepet prioritet zonës verilindore të vendit, në të cilën aktualisht nuk kemi qendra publike të formimit profesional.

d) Optimizimit të shpërndarjes dhe madhësisë së shkollave/qendrave për të përshtatur ofertën me kërkesën, për të rritur fleksibilitetin e ofertës dhe ulur kostot e këtij shërbimi publik (krijimi i shkollave/qendrave rajonale ose kombëtare). Kjo do të shoqërohet me rikonstruksione, shtesa, lirim i mjediseve të zëna forcërisht, si dhe shfrytëzim më i mirë i kapaciteteve ekzistuese.

e) Institucionalizimit të bashkëpunimit midis AFP dhe biznesit lokal për të shfrytëzuar me efektivitet infrastrukturën e këtyre aktorëve në funksion të përgatitjes profesionale të të rinjve dhe të rriturve. Bashkëpunimi me sektorin privat është shumë i rëndësishëm në reformimin e arsimit dhe formimit profesional si dhe për të siguruar një shërbim që është i kërkuar nga tregu i punës.

f) Ngritjes së një sistemi informacioni të kërkesë/ofertës në AFP, nëpërmjet futjes së internetit në sistemin arsimor, informatizimit të qendrave të formimit profesional, zyrave të punësimit dhe drejtorive rajonale të arsimit.

Arritja e këtyre objektivave si dhe realizimi i ndërhyrjeve të tjera reformuese në përputhje me situatat që do të krijohen, do të kontribuojnë në ngritjen e dukshme cilësore dhe sasiore të AFP në kuadrin e përmbushjes së misionit të këtij sektori të rëndësishëm të zhvillimit të burimeve njerëzore.

3.3.8. Masat për përmirësimin e situatës në tregun informal

Fenomeni i punës informale ka anët e veta negative si: disorientimin e tregut të punës, inkurajimin e punës së paligjshme, uljen e të ardhurave në buxhetin e shtetit, uljen e të ardhurave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, krijimin e shtresës së njerëzve të pambrojtur etj. Për minimizimin e punës së zezë janë futur metoda të reja efikase duke shfrytëzuar eksperiencën e vendeve të tjera.

Shkaqet objektive dhe subjektive të tregut informal të punës

➢Lëvizja e pakontrolluar demografike e popullsisë drejt qendrave të mëdha të banuara dhe me një nivel më të lartë ekonomik si pasojë e përqëndrimit të bizneseve në to, nevoja për punësim në këto biznese ka krijuar mundësinë e punësimit ilegal.

➢Me të ardhurat që sigurohen nga ky lloj punësimi zbutet në shkallë relative (artificialisht) varfëria e shtresave të trajtuara në skemat sociale.

➢Konkurrenca e pandershme dhe fluksi i madh i lëvizjes së fuqisë punëtore sipas kërkesë ofertës së tregut, sidomos në sektorin e ndërtimit vështirëson kontrollin dhe zbardhjen e këtij tregu të zi të punës.

➢Mungesa e një kontrolli të plotë të lëvizjes dhe qarkullimit të monedhës përbën një tjetër arsye

që favorizon dhe informalitetin.

➢Mungesa e infrastrukturës logjistike është dhe një nga arsyet objektive të këtij fenomeni.

➢Mungesa e një rrjeti të informatizuar për komunikimin ndërinstitucional rrit vështirësitë e kontrollit të tregut të zi të punës për ta mbajtur nën kontroll dhe për ta reduktuar.

➢Bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet organeve ekzekutive si: Tatim-Taksat, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore është akoma në kuadrin e marrëveshjeve ndërinstitucionale të cilat nuk përbëjnë detyrime ligjore.

➢Mungesa e një bashkëpunimi me konkret me partnerët social ka sjellë ngadalësi në ndërhyrjet në kohën e duhur në ato aktivitete ekonomike që nuk zbatojnë legjislacionin e punës në drejtim të sigurimit të punëmarrësve.

➢ Pamundësia për të mbuluar me kontroll të gjitha llojet e veprimtarive ekonomike të cilat ushtrohen larg qendrave të banuara apo zbulimi i "ekonomive të bodrumeve" sjell dhe lulëzimin e tregut informal të punës.

Lidhur sa më lart, masat kryesore për zbutjen e këtij fenomeni, ashtu siç janë përcaktuar dhe në planin e reduktimit të ekonomisë informale, të aprovuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 430, datë 28.06.2006, janë si më poshtë:

1. Vendosja e një kornize bashkëpunimi midis institucioneve, hartimi i një vendimi të Këshillit të Ministrave (Inspektorati i Punës, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Shërbimi Kombëtar i Punësimit) për shkëmbimin e informacionit të vazhdueshëm mbi situatën e tregut informal të punësimit.

2. Vendosja e një rrjeti të informatizuar dhe të kompjuterizuar si një element i rëndësishëm në marrjen e një informacioni të përhershëm dhe vendosjen e një kontrolli kompjuterik mbi regjistrin e punëmarrësve të tregut privat të punës do të shërbejë në minimizimin e punësimit ilegal; pra ndërtimi i një regjistri të përbashkët informatik i regjistrimit të subjekteve dhe të të punësuarve midis këtyre institucioneve.

3. Evidentimi i numrit të punësuarve në fushën e ndërtimit, industrisë përpunuese prodhuese (veshmbathje dhe këpucët), me anë të organizimit të aksioneve të përbashkëta midis këtyre institucioneve, si dhe verifikimi më pas për përfshirjen në skemën e sigurimeve të personave të pasiguruar të evidentuar. Në sektorin e ndërtimit gjatë muajit qershor u krye një aksion i përbashkët me tatim-taksat me synim sigurimin e zbatimit të legjislacionit të punës në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve, kontrolli ndaj evazionit fiskal, si dhe vlerësimi i masave të marra nga detyrat e lëna në kontrollet e mëparshme.

4. Zgjerimi i zonave të kontrollit, jo vetëm në zonat urbane, por shtrirja e shërbimit të inspektimit në punë dhe në ato rurale, në zbatim të Konventës 129 të ILO-s, konventë kjo që mendohet të ratifikohet brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2007.

5. Sensibilizimi i punëdhënësve për t'i siguruar punëmarrësit, jo më pak se paga minimale.

6. Kryerja e një studimi ndërsektorial mbi tregun informal, me qëllim evidentimin e shkaqeve kryesore të këtij fenomeni dhe hartimi më pas i një plani më të debatuar për reduktimin e tij.

7. Kontrolli i tregut të punës i cili do të sigurohet nëpërmjet bashkëpunimit të ISHP-së, organeve të tatim-taksave, organeve të policisë.

8. Konsolidimi i biznesit privat do të sjellë një konkurrencë transparente në tregun e punës sipas kërkesë ofertës.

Përmirësimi i metodave dhe mjeteve të kontrollit.

9. Si do të përmirësohet më tej klima e biznesit në Shqipëri?

Nëpërmjet:

- Reduktimit të mëtejshëm të barrierave administrative për hapjen dhe kryerjen e një biznesi.
- Përmirësime ligjore e institucionale për garantimin e konkurrencës së ndershme.

3.3.9 Mbrojtja dhe shëndeti në punë

Që në konceptimin e saj në vitin 1992, Ministria e Punës ka pasur një nga misionet e saj hartimin dhe vënien në zbatim të politikave në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Mbrojtja e integritetit fizik, mendor të punëmarrësve, është prioriteti që shprehet në "politikën e punës aktualisht". Institucioni zbatues i kësaj politike është Inspektorati shtetëror i punës, misioni i të cilit për vitet e ardhshme shprehet si më poshtë:

Inspektorati shtetëror i punës, si një institucion i domosdoshëm në politikat sociale të një shteti, ka si fokus kryesor në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, nëpërmjet nxitjes së zbatueshmërisë së legjislacionit të punës, mbrojtjen fizike, mendore dhe sociale të punonjësve.

Kjo politikë është në përputhshmëri të plotë me politikën e Komunitetit Europian për shëndetin

dhe sigurimin në punë, që synon përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies në punë, një koncept dhe prioriteti i ri për shërbimin e inspektimit në punë për vitet e ardhshme në Shqipëri. Promovimi i një mjedisi cilësor të punës, kërkon që të gjithë aktorët të marrin përgjegjësi të plota, çka do të thotë që përpjekjet e çdo pale duhet të jenë të hapura ndaj kontrollit dhe vlerësimit të kontrollit.

Historikisht sistemet e inspektimit në punë, vijnë si rezultat i ambientit ekonomik, politik, social-kulturor të një vendi, të cilët sjellin një përmirësim të ambientit të punës.

